INTEGRITETI AKADEMIK, PUBLIKIMI SHKENCOR, DHE MENAXHIMI I UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS



Publikues:
ORCA – Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim
www.orca-ks.org
info@orca-ks.org
Simon Shiroka, H-11, Nr. 8
Prishtina, 10000, Kosova

Tetor 2018

ORCA është anëtare e Koalicionit për Integritet dhe Transparencë në Universitet - KITU, mbështetur nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur - KFOS. Ky raport është pjesë e programit të KITU-së. Ky grant është realizuar me përkrahjen e projektit Sfidimi i Korrupcionit në Arsimin e Lartë i financuar nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS). Përmbajtja është përgjegjësi e ORCA dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i KFOS-it.

KITU
KOALICIONI PËR INTEGRITET DHE TRANSPARENCË NË UNIVERSITET

KFOS
Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
Kosovo Foundation for Open Society
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo

Ky botim është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e ORCA dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SDC-së, DANIDA-së apo KCSF-së.

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK
DANIDA | INTERNATIONAL DEVELOPMENT COOPERATION

SHPATA E DEMOKLEUT MBI KOKAT TONA

Tregonte dikur Ciceroni se Demokleu i ishte ankuar mbretit të tij, Dionisit të Sirakuzës, për pasurinë që mbreti kishte. Dionisi mbret i ofroi atij që për një ditë të ulej në fronin e tij e të provonte gjithë salltanetin e të qenët mbret. Dhe kështu u bë. Demokleu u ul në fron. Pa gjithçka të mirë e të bollshme rreth vetes dhe u kënaq pa masë. Ndjeu veten mbret. Por, pa sipër kokës së vet një shpatë që varej për një fije të hollë të flokut të kalit që rrinte si kërcënim mbi kokën e tij. Dionisi e kishte vënë këtë shpatë mbi fron për ta përshkruar se sa me rrezik është jeta e tij që gëzonte gjithë ato të mira që të tjerët si Demokleu i dëshironin aq shumë.

Ndonëse froni i pëlqeu mjaft, Demokleu e luti Dionisin ta linte të çohej, se nuk mund të duronte presionin e rrezikut që varej në një fije aq të hollë sipër kokës së tij.

Ne, jemi nën shpatë dhe kjo shpatë është cilësia e Universitetit të Prishtinës. Universiteti më i madh dhe më i mirë, të paktën i vlerësuar formalisht kështu, në të gjithë hapësirën shqipfolëse; Universiteti, historia e të cilit është aq e lidhur me historinë e vendit tonë në kuptimin e zhvillimit të tij; Universiteti që është projeksioni i të ardhmes së shoqërisë sonë; Nga ku do të dalin të gjitha profesionet, nga juristët e deri te neurokirurgët; Nga institucioni i cili prej sot projekton cilësinë e jetës sonë në të ardhmen, për 20, 30, 40 vjetët e ardhshme.

Ne, jemi nën shpatë dhe kjo shpatë është cilësia e Universitetit të Prishtinës, që është e varur me një litar të hollë për integritetin akademik, publikimin shkencor dhe menaxhimin e mirë. Nëse asgjë tjetër, ky është motivi jonë si organizatë, dhe ky duhet të jetë motivi jonë si shoqëri.

Këtë motiv për angazhim shoqëror përmes hulumtimit e kritikës publike e kemi kthyer në synim që mëtojmë ta përcjellim në gjithë shoqërinë kosovare. Ta arrijmë një jetë me mirëqenie me gjithë rreziqet që mund të ketë rruga jonë drejt asaj mirëqenie. Për rrezikun që varet në një fije të hollë sipër kokave tona duhet të sigurohemi se kunjat për të cilat është lidhur ai, janë ngulur thellë si vlera në institucionet arsimore të shoqërinë tonë. Dhe këto kunja: integriteti akademik, cilësia e publikimit shkencor dhe menaxhimi i mirë i institucioneve të arsimit në përgjithësi, e Universitetit të Prishtinës në veçanti, do të jenë garanti i mirëqenies mbretërore që aq shumë e dëshironte Demokleu.

Por Demokleu nuk kishte bërë asgjë për ta merituar fronin, atij froni iu dha, prandaj ai e braktisi, me gjithë mirëqenien, për t'i ikur rrezikut. Ne duhet të punojmë për ta krijuar fronin e mirëqenies për shoqërinë tonë, dhe pasi të jemi angazhuar shumë që rreziqet të jenë të shtrënguara fort pas vlerave tona më të larta morale e etike si shoqëri, atëherë ne do të mund t'i gëzohemi mirëqenies për sa të jetë koha

Tabela e përmbajtjes

Parathënie nga Jeffrey Beall 5

Parathënie nga Taulant Muka 7

Analiza e publikimit shkencor në UP 10

Justifikimi i titujve akademikë të profesorëve në Universitetin e Prishtinës 42

Analiza e konkursit për zgjedhjen e personelit akademik mësimdhënës në Universitetin e Prishtinës 2018 59

Analiza e mbajtjes së ligjëratave nga stafi pa titull akademik të profesorit në Universitetin e Prishtinës 80

Analiza e menaxhimit të financave për pagat e stafit akademik në Universitetin e Prishtinës 99

PARATHËNIE

*Nga profesor **Jeffrey Beall** (i pensionuar)*



Jeffrey Beall është një profesor i asocuar dhe bibliotekar akademik i pensionuar në Universitetin e Kolorados Denver. Më parë ai ka punuar si bibliotekar në Universitetin e Harvard. Pas identifikimit dhe emërimmit të fenomenit të botuesve grabitqarë, ai ka publikuar lista të tyre nga 2011 deri 2017. Hulumtimet dhe shkrimet e tij për botimin shkencor janë publikuar në shumë revista shkencore, dhe ai është ftuar të flasë në shumë konferenca e seminare në Amerikë Veriore, Azi, dhe Evropë.

Për të dytën herë, ORCA më ka ftuar të shkruaj parathënien e analizës së saj vjetore, dhe jam i lumtur ta shkruaj. Raporti i këtij viti dokumenton arritje të rëndësishme nga fakultetet e Universitetit të Prishtinës dhe nga vetë ORCA.

Këto arritje reflektojnë kreativitetin dhe punën e profesorëve të universitetit në njërën anë dhe përpjekjet dhe ndikimin e ORCA-s në anën tjetër

Një nga funksionet kryesore të universiteteve moderne është hulumtimi. Ky hulumtim, që shpërndahet përmes librave, revistave, konferencave shkencore dhe metodave tjera, ndihmon të përmirësojë kushtet sociale dhe ekonomike të shoqërisë dhe ofron përmirësime në shëndetin publik, teknologji, inxhinieri, dhe në arte e shkenca humane.

Prandaj, nuk është e befasishme që universitetet, duke përfshirë UP-në, përdorin hulumtime të publikuara për të marrë vendime rreth vlerësimit dhe avancimit të profesorëve.

Gjatë nëntë viteve të fundit që kam punuar si bibliotekar akademik në Universitetin e Kolorados, kam dokumentuar një problem që po rritet në publikimin e hulumtimeve, lindjen e atyre që unë quaj revista grabitqare – të cilat në këtë raport quhen revista të dyshimta. Me çfarëdo emri, këto revista janë revista false akademike, që kanë mashtruar shumë njerëz, duke botuar hulumtime pa procese recenzimi të duhura në shkëmbim të pagesave nga hulumtuesit.

Gjithashtu, në gjithë botën, disa profesorë dhe të tjerë kanë përdorur qëllimisht botuesit grabitqarë për të botuar lehtësisht artikuj, dhe punime që pastaj i shtojnë në CV. Ky lloj mashtrimi korrupton sistemet vlerësuese të bazuara në publikimin shkencor dhe ndot dijeninë shkencore.

Përpjekjet për të luftuar botuesit grabitqarë dhe për të rivendosur integritetin akademik janë kyçe në misionin e ORCA-s, dhe ky raport dokumenton punën e organizatës. Në fakt, emri i ORCA-s, “Organizata për rritjen e cilësisë në arsim”, direkt përputhet me të arriturat e saj të vazhdueshme në vitin e kaluar.

Është e qartë që integriteti akademik është një prioritet kombëtar në Kosovë gjithashtu, sepse ky shtet ka miratuar legjislacion këtë vit që rregullon publikimet e hulumtimeve nga universitetet në revista shkencore të respektuara, në vend të dyshimta.

Disa shtete nuk kanë mekanizma të zbatimit të integritetit akademik, dhe hulumtuesit e këtyre shteteve e kanë marrë rrugën e lehtë dhe publikojnë vazhdimisht në revista të shpejta, të lehta dhe grabitqare. Rrjedhimisht, hulumtimi nga

këto shtete konsiderohet i diskutueshëm dhe madje i dyshimtë, dhe universitetet e tyre kanë humbur respektin ndërkombëtar.

Sidoqoftë, situata është ndryshe në Kosovë. Falë udhëzimeve të miratuara nga Ministria e Arsimit e Republikës së Kosovës, rregullores për avancime akademike e miratuar nga Universiteti i Prishtinës, dhe falë punës së ORCA-s, integriteti i hulumtimit vlerësohet dhe zbatohet këtu. Ky zbatim i demonstron botës që Kosova është serioze për etikat e botimit shkencor dhe hulumtuesit e saj kanë standarde më të larta.

Pak shtete kanë ndërmarrë hapa kaq të guximshëm, prandaj Kosova dallohet si lider botëror për promovimin e integritetit në komunikimin shkencor. Për më shumë, ORCA, që ka mbështetur këtë legjislacion dhe që ishte shumë e dobishme gjatë miratimit të saj, jep shembull që duhet ta ndjekin shtetet e tjera.

Analiza e këtij viti sjell kryesisht lajme të mira. Isha sidomos i impresionuar nga grafikat që dokumentojnë numrin e "publikimeve në revista të dyshimta". Këto grafika janë shumë inkurajuese, sepse në përgjithësi tregojnë një rënie drastike në numrin e publikimeve të tilla nga profesorët e UP-së. Të dhënat tregojnë që është e mundshme të mbash standarde të larta akademike dhe të vazhdosh të prodhosh hulumtime.

Është gjithashtu e mrekullueshme të shohësh që "ka ngritje të vetëdijes për përditësimin e CV-ve [të profesorëve]", siç raporton raporti. Rutina e përditësimit të CV-ve ndihmon edhe universitetin edhe profesorët, sepse rrit transparencën dhe tregon prodhimtarinë hulumtuese të universitetit.

Më lejoni të përsëris çfarë kam thënë më parë: qytetarët e Kosovës janë me fat që kanë një organizatë si ORCA. Është një ndër OJQ-të më të mira që demonostron lidership të mrekullueshëm në promovimin dhe sigurimin e integritetit akademik në arsim të lartë.

Unë shpresoj që ORCA të mund të vazhdojë hulumtimin dhe publikimin e kësaj analize vjetore për shumë vjet në vijim.

PARATHËNIE

Nga doktor ***Taulant Muka***



Taulant Muka është mjek shkencëtar, me një interes të lartë në procesin e plakjes, e kryesisht mbi sëmundjet kardiometabolike, shëndetin e gruas dhe epigjenetikën. Dr Muka punon aktualisht si drejtues i një grupi kërkimor në "Institute of Social and Preventive Medicine" (ISPM-Bern) në Universitetin e Bern në Zvicër. Ai mbrojti doktoraturën në Qendrën Mjekësore Erasmus në Hollandë, ku dhe vazhdoi studimet postdoktorale. Ai ka gjithashtu eksperienca kërkimore në Universitetin e Harvardit dhe Kembrixhit. Dr. Muka ka publikuar mbi 60 artikuj shkencorë në revistat më mira në fushën e mjekësisë (JAMA, European Heart Journal, BMJ, Circulation Research), ka dhënë mësim në universitete, është përfshirë në shkrimin e librave të publikuar nga Elsevier dhe deri më tani ka mbikëqyrë plotësimin e 3 doktoraturave. Puna e tij shkencore ka marrë disa herë vëmendjen e mediave globale (BBC, CNN, Reuters, TIMES). Puna gjatë vitit të fundit në zyrat qendrore të Novo Nordisk në Danimarkë si mjek farmaceutik e ka ndihmuar Dr. Mukën të zgjerojë njohuritë e tij mbi zhvillimin e barnave te rejave dhe realizimin e studimeve klinike.

Revistat grabitqare bëjnë para duke ofruar një proces të shpejtë të publikimit të punëve kërkimore më cilësi të ulët dhe pa një vlerësim paraprak nga një bord editorial ose kolegët recenzent. Kjo ka një ndikim të drejtpërdrejtë në dhënien e titujve akademik pasi ndihmon individë pa vlera shkencore dhe akademikë të marrin titullin "doktorant", "profesor i asocuar" apo "profesor".

Ky fenomen ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e universiteteve dhe programeve të studimit që universitetet ofrojnë. Një tjetër problem që vendet si Kosova hasin është dhe mosrespektimi i ligjit për dhënien e titujve akademikë, pra dhënia e titujve akademikë në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në ligj. Kjo rrit edhe më shumë prezencën e "pseudoakademikëve" në auditore me një impakt negativ në mësimdhënie,

punën kërkimore por edhe me impakt negativ financiar dhe social.

ORCA, përmes vlerësimit rigoroz të CV-ve të stafit akademik të Universitetit të Prishtinës, përdorimit të të dhënave nga databazat bibliografike si dhe listës së Beallit për revistat "grabitqare", paraqet indikatorë të rëndësishem të vlerësimit të këtyre dy aspekteve. Raporti tregon se një në dy pjesëtarë të stafit akademik të rregullt në Universitetin e Prishtinës

nuk publikon në revista të cilat janë të indeksuara në databazat bibliografike, dhe se 1 në 3 publikojnë në revista të dyshimta ("grabitqare"). Këto janë të dhëna të rëndësishme që tregojnë se niveli i punës kërkimore ne Universitetin e Prishtinës mund të mos jetë në nivelin e kërkuar, përkundrazi mund të jetë i limituar në cilësi e për rrjedhojë në impaktin që këto botime mund të kenë. Këto të dhëna janë tregues i rëndësishëm se këto punime jo cilësore mund të përdoren për marrjen e titujve akademikë në Kosovë. Në fakt, ORCA në raportin e paraqitur tregon se nga 465 akademikë të marrë në shqyrtim, më shumë se gjysma mund t'i kenë marrë titujt akademikë jo në përputhshmëri me rregullat në fuqi. Këto shifra janë indikatorë domethënës që tregojnë abuzimin e mundshëm me dhënien e titujve akademikë në Kosovë, dhe që duhet të nxisin shqyrtimin zyrtar të dosjeve nga aplikuesit që kanë marrë titujt akademikë në Universitetin e Prishtinës, dhe marrjen e masave nga institucionet e arsimit të lartë dhe Ministria e Arsimit në Kosovë. Shtrirja në të ardhmen e këtij investigimi të paraqitur nga ORCA edhe në aspektin e performancës së akademikëve pas momentit të marrjes së titullit akademik, do ishte i nevojshëm për të nxitur edhe më tej punën shumë të mirë që ORCA po bën për të nxitur rritjen e cilësisë në Universitetin e Prishtinës por edhe në institucionet e tjera të arsimit të lartë në Kosovë.

Integriteti akademik

ANALIZA E PUBLIKIMIT SHKENCOR NË UP

Analizë e aktivitetit shkencor të profesorëve të Universitetit të Prishtinës, sipas CV-ve të publikuara zyrtarisht – 2018

Publikues:
ORCA – Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim
www.orca-ks.org
info@orca-ks.org
Simon Shiroka, H-11, Nr. 8
Prishtina, 10000, Kosova

Autore:
Adea Kondirolli

Editor:
Rron Gjinovci

Hulumtuesit:
Adea Kondirolli, Durim Jasharaj,
Gramos Buçinca, Robert Pajaziti, Venera Çoçaj

Prishtinë, tetor 2018

HYRJE

Si rrjedhojë e presionit të ORCA-s pas raportit të fundit të integritetit akademik të profesorëve të UP-së[1], në të cilin doli se 72% e profesorëve nuk i justifikojnë titujt e tyre akademikë, u hartua Udhëzimi Administrativ 01/2018 Parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension[2]. ORCA ka marrë pjesë në grupin punues të këtij Udhëzimi Administrativ, i cili kishte për qëllim definimin e revistave shkencore që pranohen për zgjedhjen e stafit akademik në universitete publike.

Ky udhëzim u ndoq nga Rregullorja 465 për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina"[3], i cili precizoi edhe më tej UA-në duke i definuar platformat e indeksimit në të cilat revistat që pranohen nga Universiteti pranohen për zgjedhje të stafit akademik.

Përmes këtyre rregullativave, publikimi shkencor në universitete publike, specifikisht në Universitetin e Prishtinës, u definua kënaqshëm.

Natyrisht, profesorët e Universitetit të Prishtinës kanë gjetur hapësira për interpretim dhe mashtrim akademik. Vetëm në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, 10 profesorë kanë botuar 5 deri në 19 herë në vit në disa revista të indeksuara në platformat e indeksimit të pranuara, por që lënë shumë për të dëshiruar në aspektin cilësor.[4]

"Supermenët" e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike kanë arritur të botojnë 40 punime vetëm gjatë vitit 2017.

Sidoqoftë, Universiteti i Prishtinës ka shënuar përmirësim në numrin e punimeve shkencore krahasuar me hulumtimin në vitin 2017.

Në vitin 2017, në UP kanë qenë 1320 punime, ndërsa në vitin 2018 janë 1735. Përpjesëtuar me numrin e stafit akademik në vitin 2018 që është 465 profesorë, del se një profesor në Universitetin e Prishtinës ka mesatarisht 3.7 punime. Në vitin 2017 kjo mesatare ka qenë 2.7.

Por, 9 nga 12 fakultetet e UP-së e kanë mesataren më të ulët se mesatarja në nivel të universitetit. Vetëm Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore, Fakulteti i Mjekësisë dhe Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë kanë më shumë punime se mesatarja e UP-së. Kjo tregon që në fakultetet e shkencave joekzakte ka mungesë të thellë punimesh shkencore.

Menaxhmenti i Universitetit të Prishtinës duhet ta trajtojë seriozisht mungesën e punimeve shkencore në shumicën e fakulteteve.

1 http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2017/12/Integriteti-akademik-i-profesoreve-ne-Universitetin-e-Prishtines.pdf

2 Udhëzimi Administrativ 01/2018 Parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension: http://masht.rks-gov.net/uploads/2018/01/ua-nr-01-2018-parimet-e-njohjes-se-platoformave-dhe-revistave-nderkombetare-me-recension.pdf

3 Rregullorja 465 për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina": https://www.uni-pr.edu/desk/inc/media/C15E46D5-5159-4E97-B8CB-D69734E39CA4.pdf

4 http://orca-ks.org/sq/2018/07/19/supermenet-e-fakultetit-te-inxhinierise-mekanike/

TË DHËNAT E PËRGJITHSHME


Punimet e publikuara dhe pjesëmarrja

Në intervalin kohor ndërmjet 1980–2018[5] ka gjithsej 1735 punime të publikuara në revista me koeficient, në të cilat profesorët e UP-së mund të jenë në radhë të ndryshme të autorësisë, nga to 1253 janë në cilësinë e autorit të parë ose korrespondent. Në hulumtimin e bërë në vitin 2017, si autor i parë ose korrespondent kanë qenë 747 punime.

Viti 2017 shënon pikun e numrit të punimeve të publikuara në revistat që i plotësojnë kriteret, gjatë të cilit janë botuar 220 punime.

Kjo rritje e numrit të punimeve të publikuara është për disa arsye: Rritja e vetëdijes së profesorëve për përditësimin e CV-ve, për shkak të analizave të shumta të ORCA-s që bazohen në këto dokumente; rritja e vetëdijesimit për nevojën e aktivitetit të vazhdueshëm shkencor si mjet për përmirësimin e gjendjes së arsimit dhe për avancimet e profesorëve; dhe lehtësimet që kanë ardhur me adaptimin e Udhëzimit Administrativ dhe Rregullores.

Punimet në revista me koeficient




Në intervalin kohor ndërmjet viteve 2007–2018[6] ka gjithsej 502 punime të publikuara në revista të dyshimta nga 153 profesorë. Në hulumtimin e bërë në vitin 2017 kanë qenë 352 punime.

Viti 2013 shënon pikun e numrit të punimeve të publikuara në revista të dyshimta, të cilat nuk i plotësojnë kriteret dhe parimet e përcaktuara në metodologji, me 97 sosh.

5 Punimi i parë i regjistruar në një revistë që i plotëson kriteret është nga viti 1980.

6 Punimi i parë i regjistruar në një revistë që nuk i plotëson kriteret është nga viti 2007.

Publikimi në revista të dyshimta



Nga grafikët e mësipërm vërehet proporcion i drejtë mes punimeve të publikuara dhe pjesëmarrjes, si në revista me koeficient po ashtu në revista të dyshimta.

257 profesorë (55%) kanë të paktën nga 1 punim të publikuar në revista me koeficient. 153 profesorë (33%) kanë publikuar së paku një herë në revista të dyshimta.

Punimet sipas fakulteteve

Mesatarja e punimeve të publikuara në revista me koeficient është 3.7 punime për profesor në nivel universiteti.

Fakulteti me më së shumti punime për profesor është Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore me 8 punime për profesor. Pas tij vjen Fakulteti i Mjekësisë me 6 punime për profesor, i pasuar nga Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë me 5.5 punime për profesor.

Ndërsa, sa u përket fakulteteve të shkencave joekzakte prin Fakulteti i Edukimit me 2.6 punime për profesor, gjë që është nën mesataren e përgjithshme të Universitetit të Prishtinës.

Fakulteti me më së paku punime për profesor është Fakulteti i Filologjisë me 0.92 punime për profesor.

Aneks 1. *Tabela e punimeve në revista sipas fakulteteve*

Tabela e punimeve në revista shkencore sipas fakulteteve			
Nr.	**Fakultetet në UP**	**Punimet në revista shkencore**	**Punime në revista të dyshimta**
1	Fakulteti Filozofik	35	10
2	Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore	524	180
3	Fakulteti i Filologjisë	36	7
4	Fakulteti Juridik	74	21
5	Fakulteti Ekonomik	98	50
6	Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës	48	10
7	Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Komp-juterike	57	25
8	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	94	16
9	Fakulteti i Mjekësisë	528	107
10	Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë	184	34
11	Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit	14	0
12	Fakulteti i Edukimit	94	42
TOTAL		1735	502

Aneks 2. *Tabela e renditjes së fakulteteve sipas numrit të punimeve për profesor*

Nr.	Fakultetet në UP	Publikime në revista me koeficient	Numri i profesorëve	Punime/profesor
1	Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore	524	65	8.06
2	Fakulteti i Mjekësisë	528	87	6.07
3	Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë	184	33	5.58
4	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	94	29	3.24
5	Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike	57	21	2.71
6	Fakulteti i Edukimit	94	36	2.61
7	Fakulteti Ekonomik	98	44	2.23
8	Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës	48	23	2.09
9	Fakulteti Juridik	74	42	1.76
10	Fakulteti Filozofik	35	32	1.09
11	Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit	14	14	1.00
12	Fakulteti i Filologjisë	36	39	0.92
TOTAL		1735	465	3.73

Fakulteti i Edukimit


Publikimi në revista me koeficient

Fakulteti i Edukimit ka gjithsej 94 punime të publikuara nga profesorët e tij.

Në intervalin kohor ndërmjet viteve 1995–2017 ka 20 pjesëmarrje në publikimin e punimeve në revista shkencore[7] nga autorë të ndryshëm.

Për autor të parë ose korrespondent për të njëjtin interval kohor, pjesëmarrja në publikim mbërrin në 84.

Punimet në revista me koeficient



7 Përdoret fjala "pjesëmarrje" për të treguar se numri 20 në këtë rast nuk shënon numrin e punimeve shkencore. Në të njëjtat punime mund të ketë dy e më shumë autorë, prandaj ky numër tregon vetëm pjesëmarrjen e autorëve në punime shkencore.

Publikimi në revista të dyshimta


13 profesorë kanë 42 punime në 24 revista të dyshimta. 7 nga ta bëjnë pjesë në grupin e profesorëve që i justifikojnë titujt akademikë, ndërsa 6 nga grupi i profesorëve që nuk i justifikojnë titujt akademikë.

Profesorët e Fakultetit të Edukimit kanë gjithsej 42 pjesëmarrje në publikimin e punimeve në 24 revista të dyshimta.

Për autor të parë ose korrespondent në intervalin kohor 2007–2015[8], përfshirja në publikim mbërrin në 29 pjesëmarrje.

Viti me më së shumti përfshirje të autorëve në publikimin e punimeve në revista të dyshimta është viti 2013, gjatë të cilit janë 11 pjesëmarrje.

Publikimi në revista të dyshimta



8 Punimi i parë në Fakultetin e Edukimit i regjistruar në një revistë që nuk i plotëson kriteret është nga viti 2007, ndërsa i fundit në vitin 2015.

Fakulteti Ekonomik


Publikimi në revista me koeficient

Fakulteti Ekonomik ka gjithsej 98 punime të publikuara në revista me koeficient.

Në intervalin kohor ndërmjet viteve 2004–2017 ka 29 pjesëmarrje në publikimin e punimeve në revista shkencore[9] nga autorë të ndryshëm.

Për autor të parë ose korrespondent në të njëjtin interval kohor, pjesëmarrja në publikim mbërrin në 85.

Punimet në revista me koeficient



9 Përdoret fjala "pjesëmarrje" për të treguar se numri 29 në këtë rast nuk shënon numrin e punimeve shkencore. Në të njëjtat punime mund të ketë dy e më shumë autorë, prandaj ky numër tregon vetëm pjesëmarrjen e autorëve në punime shkencore.

Publikimi në revista të dyshimta


15 profesorë kanë 50 punime në 19 revista të dyshimta.

Profesorët e Fakultetit Ekonomik kanë gjithsej 50 pjesëmarrje në publikimin e punimeve në 19 revista të dyshimta.

Për autor të parë ose korrespondent në intervalin kohor 2010-2017[10], përfshirja në publikim mbërrin në 33 pjesëmarrje.

Viti me më së shumti përfshirje të autorëve në publikimin e punimeve në revista të dyshimta është viti 2012, gjatë të cilit janë 15 punime të publikuara.

Publikimi në revista të dyshimta



10 Punimi i parë në Fakultetin Juridik i regjistruar në një revistë që nuk i plotëson kriteret është i vitit 2010, ndërsa i fundit në vitin 2017.

Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë (FBV)


Publikimi në revista me koeficient

Profesorët e Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë kanë gjithsej 184 punime shkencore të publikuara në revista me koeficient.

Në intervalin kohor ndërmjet viteve 1990–2017 ka gjithsej 153 pjesëmarrje në publikimin e punimeve në revista shkencore[11] nga autorë të ndryshëm.

Për autor të parë ose korrespondent në të njëjtin interval kohor pjesëmarrja në publikim mbërrin në 103.

Punimet në revista me koeficient



11 Përdoret fjala "pjesëmarrje" për të treguar se numri 153 në këtë rast nuk shënon numrin e punimeve shkencore. Në të njëjtat punime mund të ketë dy e më shumë autorë prandaj ky numër tregon vetëm pjesëmarrjen e autorëve në punime shkencore.

Publikimi në revista të dyshimta


17 profesorë kanë punime në revista të dyshimta. 9 nga ta bëjnë pjesë në grupin e profesorëve që i justifikojnë titujt akademikë, ndërsa 8 në grupin e profesorëve që nuk i justifikojnë titujt akademikë.

Profesorët e FBV-së kanë marrë pjesë në publikimin e 34 punimeve në 11 revista të dyshimta.

Për autor të parë ose korrespondent në intervalin kohor 2010–2016[12] përfshirja në publikim mbërrin në 14 pjesëmarrje.

Vitet me më së shumti përfshirje të autorëve në publikimin e punimeve në revista të dyshimta janë vitet 2012 dhe 2013, me 8 dhe 11 pjesëmarrje respektivisht.

Publikimi në revista të dyshimta



12 Punimi i parë në FBV i regjistruar në një revistë që nuk i plotëson kriteret është në vitin 2010, ndërsa i fundit në 2016.

Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit (FEFS)


Publikimi në revista me koeficient

Profesorët e Fakultetit të Edukimit Fizik dhe të Sportit kanë gjithsej 14 punime shkencore të publikuara në revista me koeficient.

Në intervalin kohor ndërmjet viteve 1994–2011 ka gjithsej 14 pjesëmarrje në publikimin e punimeve në revista shkencore[13] nga autorë të ndryshëm.

Për autor të parë ose korrespondent në të njëjtin interval kohor pjesëmarrja në publikim mbërrin në 2.

Punimet në revista me koeficient



13 Përdoret fjala "pjesëmarrje" për të treguar se numri 14 në këtë rast nuk shënon numrin e punimeve shkencore. Në të njëjtat punime mund të ketë dy e më shumë autorë, prandaj ky numër tregon vetëm pjesëmarrjen e autorëve në punime shkencore.

Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (FIEK)


Publikimi në revista me koeficient

Profesorët e Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike kanë gjithsej 57 punime shkencore të publikuara në revista me koeficient.

Në intervalin kohor ndërmjet viteve 2003–2018 ka gjithsej 32 pjesëmarrje në publikimin e punimeve në revista shkencore[14] nga autorë të ndryshëm.

Për autor të parë ose korrespondent në të njëjtin interval kohor pjesëmarrja në publikim mbërrin në 44.

Punimet në revista me koeficient



14 Përdoret fjala "pjesëmarrje" për të treguar se numri 32 në këtë rast nuk shënon numrin e punimeve shkencore. Në të njëjtat punime mund të ketë dy e më shumë autorë, prandaj ky numër tregon vetëm pjesëmarrjen e autorëve në punime shkencore.

Publikimi në revista të dyshimta


9 profesorë kanë 25 punime në 16 revista të dyshimta.

Profesorët e Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike kanë gjithsej 25 pjesëmarrje në publikimin e punimeve në 16 revista të dyshimta.

Për autor të parë ose korrespondent në intervalin kohor 2011–2016[15] përfshirja në publikim mbërrin në 13 pjesëmarrje.

Vitet me më së shumti përfshirje të autorëve në publikimin e punimeve në revista të dyshimta janë 2012 dhe 2013, me nga 6 pjesëmarrje.

Publikimi në revista të dyshimta



15 Punimi i parë në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike i regjistruar në një revistë që nuk i plotëson kriteret është i vitit 2011, ndërsa i fundit në vitin 2016.

Fakulteti i Filologjisë

Publikimi në revista me koeficient


Në intervalin kohor që kufizohet në vitet 2007–2018 ka gjithsej 36 punime në revista me koeficient.

Në intervalin kohor ndërmjet periudhës 2007–2018 ka vetëm 1 pjesëmarrje në publikimin e punimeve në revista shkencore[16] nga autorë të ndryshëm.

Ka 37 pjesëmarrje si autor i parë ose korrespondent.

Fakulteti i Filologjisë është njëri nga fakultetet me më së paku punime shkencore në revista shkencore ndërkombëtare.

Punimet në revista me koeficient




16 Përdoret fjala "pjesëmarrje" për të treguar se numri 1 në këtë rast nuk shënon numrin e punimeve shkencore. Në të njëjtat punime mund të ketë dy e më shumë autorë, prandaj ky numër tregon vetëm pjesëmarrjen e autorëve në punime shkencore.

Publikimi në revista të dyshimta

Një profesor (i asocuar) ka 7 punime në revista të dyshimta.

Viti me më së shumti përfshirje të autorëve në publikimin e punimeve në revista që nuk i plotësojnë kriteret dhe parimet e përcaktuara në metodologji është viti 2016, gjatë të cilit janë 6 pjesëmarrje.

Publikimi në revista të dyshimta



Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike (FIM)

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike është shkelësi më i madh i integritetit akademik në Universitetin e Prishtinës. Në këtë fakultet, në konkursin e fundit për avancime 1-173 të datës 27.04.2018, kanë konkurruar 10 profesorë që kanë botuar 5-19 punime brenda një viti e gjysmë, me një mesatare prej 5.5 punimesh në vit për profesor. Këto punime janë të botuara në revista të indeksuara, por që lënë shumë për të dëshiruar në aspektin cilësor.

Këta profesorë i kanë përditësuar CV-të e tyre me këto punime dhe ato janë të reflektuara brenda analizës. Këto punime dallohen qartë në grafikën e mëposhtme, ku në vitin 2016 janë vetëm 10 punime, ndërsa në 2017 janë 40.


Publikimi në revista me koeficient

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike ka gjithsej 94 punime të publikuara në revista me koeficient nga profesorët e tij.

Në intervalin kohor që kufizohet në vitet 1999–2018 ka gjithsej 40 pjesëmarrje në publikimin e punimeve në revista shkencore[17] nga autorë të ndryshëm.

Për autor të parë ose korrespondent në të njëjtin interval kohor pjesëmarrja në publikim mbërrin në 118.

Punimet në revista me koeficient



17 Përdoret fjala "pjesëmarrje" për të treguar se numri 40 në këtë rast nuk shënon numrin e punimeve shkencore. Në të njëjtat punime mund të ketë dy e më shumë autorë, prandaj ky numër tregon vetëm pjesëmarrjen e autorëve në punime shkencore.


Publikimi në revista të dyshimta

9 profesorë të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike kanë gjithsej 16 punime në 8 revista të dyshimta.

Për autor të parë ose korrespondent në intervalin kohor 2009–2015[18], përfshirja në publikim mbërrin në 6 pjesëmarrje.

Viti me më së shumti përfshirje të autorëve në publikimin e punimeve të dyshimta është viti 2013, me 6 pjesëmarrje.

Publikimi në revista të dyshimta



18 Punimi i parë në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike i regjistruar në një revistë që nuk i plotëson kriteret është i vitit 2009, ndërsa i fundit në vitin 2015.

Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës (FNA)

Publikimi në revista me koeficient


Profesorët e Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës kanë gjithsej 48 punime shkencore të publikuara në revista me koeficient.

Në intervalin kohor ndërmjet viteve 1988–2018 ka gjithsej 4 pjesëmarrje në publikimin e punimeve në revista shkencore[19] nga autorë të ndryshëm.

Për autor të parë ose korrespondent në të njëjtin interval kohor pjesëmarrja në publikim mbërrin në 48.

Në grafikun e mëposhtëm vërehet një periudhë e mungesës së veprimtarisë shkencore për sa u përket punimeve të publikuara në revista me koeficient mes viteve 1988–2009.

Punimet në revista me koeficient



19 Përdoret fjala "pjesëmarrje" për të treguar se numri 4 në këtë rast nuk shënon numrin e punimeve shkencore. Në të njëjtat punime mund të ketë dy e më shumë autorë, prandaj ky numër tregon vetëm pjesëmarrjen e autorëve në punime shkencore.

Publikimi në revista të dyshimta


3 profesorë kanë punime në revista të dyshimta. Njëri bën pjesë në grupin e profesorëve të rregullt dhe e justifikon titullin, 2 janë të asocuar por që nuk e justifikojnë titullin.

Profesorët e FNA-së kanë gjithsej 10 pjesëmarrje në publikimin e 10 punimeve në 4 revista që nuk i plotësojnë kriteret dhe parimet e përcaktuara në metodologji.

Për autor të parë ose korrespondent në intervalin kohor 2010–2015[20] përfshirja në publikim mbërrin në 6 pjesëmarrje.

Vitet me më së shumti përfshirje të autorëve në publikimin e punimeve në revista të dyshimta janë vitet 2014 dhe 2015 me nga 3 pjesëmarrje.

Publikimi në revista të dyshimta



20 Punimi i parë në FNA i regjistruar në një revistë që nuk i plotëson kriteret është i vitit 2010, ndërsa i fundit në vitin 2015.

Fakulteti i Shkencave Matematike - Natyrore (FShMN)

Publikimi në revista me koeficient


Profesorët e Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore kanë gjithsej 524 punime shkencore të publikuara në revista me koeficient.

Në intervalin kohor ndërmjet viteve 1987–2018 ka gjithsej 322 pjesëmarrje në publikimin e punimeve në revista shkencore[21] nga autorë të ndryshëm.

Për autor të parë ose korrespondent në të njëjtin interval kohor, pjesëmarrja në publikim mbërrin në 381.

Viti me më së shumti pjesëmarrje në publikimin e punimeve në revista me koeficient është viti 2016, gjatë të cilit shënohen 75 pjesëmarrje.

Punimet në revista me koeficient



21 Përdoret fjala “pjesëmarrje” për të treguar se numri 322 në këtë rast nuk shënon numrin e punimeve shkencore. Në të njëjtat punime mund të ketë dy e më shumë autorë, prandaj ky numër tregon vetëm pjesëmarrjen e autorëve në punime shkencore.

Publikimi në revista të dyshimta


42 profesorë kanë punime në revista të dyshimta. 26 nga ta bëjnë pjesë në grupin e profesorëve që i justifikojnë titujt akademikë, ndërsa 16 nga grupi i profesorëve që nuk i justifikojnë titujt akademikë.

Profesorët e FShMN-së kanë gjithsej 180 punime në 43 revista të dyshimta.

Për autor të parë ose korrespondent në intervalin kohor 2008–2018[22], përfshirja në publikim mbërrin në 75 pjesëmarrje.

Viti me më së shumti përfshirje të autorëve në publikimin e punimeve në revista të dyshimta është viti 2013, gjatë të cilit janë 32 pjesëmarrje.

Publikimi në revista të dyshimta



22 Punimi i parë në FShMN i regjistruar në një revistë që nuk i plotëson kriteret është nga viti 2008, ndërsa i fundit në vitin 2018.

Fakulteti Juridik


Publikimi në revista me koeficient

Fakulteti Juridik ka gjithsej 74 punime të publikuara në revista me koeficient nga profesorët e tij.

Në intervalin kohor që kufizohet në vitet 1998–2017 ka gjithsej 3 pjesëmarrje në publikimin e punimeve në revista shkencore[23] nga autorë të ndryshëm.

Për autor të parë ose korrespondent në të njëjtin interval kohor pjesëmarrja në publikim mbërrin në 71.

Punimet në revista me koeficient



23 Përdoret fjala "pjesëmarrje" për të treguar se numri 3 në këtë rast nuk shënon numrin e punimeve shkencore. Në të njëjtat punime mund të ketë dy e më shumë autorë, prandaj ky numër tregon vetëm pjesëmarrjen e autorëve në punime shkencore.


Publikimi në revista të dyshimta

4 profesorë kanë 21 punime në 16 revista të dyshimta. Të gjithë janë profesorë të asocuar që i justifikojnë titujt. Njëri nga ta ka 17 nga 21 punimet e përmendura.

Për autor të parë ose korrespondent në intervalin kohor ndërmjet viteve 2011–2017[24] përfshirja në publikim mbërrin në 20 pjesëmarrje.

Viti me më së shumti përfshirje të autorëve në publikimin e punimeve në revista të dyshimta është viti 2016, gjatë të cilit janë 6 pjesëmarrje.

Publikimi në revista të dyshimta



24 Punimi i parë në Fakultetin Juridik i regjistruar në një revistë që nuk i plotëson kriteret është në vitin 2011, ndërsa i fundit në 2017.

Fakulteti i Mjekësisë

Publikimi në revista me koeficient

Profesorët e Fakultetit të Mjekësisë kanë gjithsej 528 punime shkencore të publikuara në revista me koeficient.


Në intervalin kohor ndërmjet viteve 1980[25]–2017 ka gjithsej 466 pjesëmarrje në publikimin e punimeve në revista shkencore[26] nga autorë të ndryshëm.

Për autor të parë ose korrespondent në të njëjtin interval kohor pjesëmarrja në publikim mbërrin në 246.

Në grafikun e mëposhtëm vërehet një rritje e shpejtë e pjesëmarrjes në publikimin e punimeve në revista me koeficient gjatë viteve 2009–2011. 3-vjeçari i ardhshëm shënon një rënie relativisht të theksuar.

Viti 2009 shënon pikun e publikimeve të punimeve në revista me koeficient, me 69 sosh.

Punimet në revista me koeficient



25 Në vitin 1980 shënohen dy punime si të parat të regjistruara në Universitetin e Prishtinës.

26 Përdoret fjala "pjesëmarrje" për të treguar se numri 466 në këtë rast nuk shënon numrin e punimeve shkencore. Në të njëjtat punime mund të ketë dy e më shumë autorë, prandaj ky numër tregon vetëm pjesëmarrjen e autorëve në punime shkencore.

Publikimi në revista të dyshimta


33 profesorë kanë punime në revista të dyshimta. 17 nga ta bëjnë pjesë në grupin e profesorëve që i justifikojnë titujt akademikë, ndërsa 16 në grupin e profesorëve që nuk i justifikojnë titujt akademikë.

Profesorët e Fakultetit të Mjekësisë kanë gjithsej 107 punime në 32 revista të dyshimta.

Për autor të parë ose korrespondent në intervalin kohor 2008-2017[27] përfshirja në publikim mbërrin në 40 pjesëmarrje.

Viti me më së shumti përfshirje të autorëve në publikimin e punimeve në revista të dyshimta është viti 2015, gjatë të cilit janë 27 pjesëmarrje.

Publikimi në revista të dyshimta



27 Punimi i parë në Fakultetin e Mjekësisë i regjistruar në një revistë që nuk i plotëson kriteret është në vitin 2008, ndërsa i fundit në 2017.

Fakulteti Filozofik

Publikimi në revista me koeficient


Profesorët e Fakultetit Filozofik kanë gjithsej 35 punime në revista me koeficient.

Në intervalin kohor që kufizohet në vitet 1995–2017 ka gjithsej 6 pjesëmarrje në publikimin e punimeve në revista shkencore[28] nga autorë të ndryshëm.

Për autor të parë ose korrespondent në të njëjtin interval kohor pjesëmarrja në publikim mbërrin në 34.

Kjo situatë shënon një nga fakultetet me numrin më të vogël të punimeve të publikuara në revista me koeficient.

Punimet në revista me koeficient



28 Përdoret fjala "pjesëmarrje" për të treguar se numri 6 në këtë rast nuk shënon numrin e punimeve shkencore. Në të njëjtat punime mund të ketë dy e më shumë autorë, prandaj ky numër tregon vetëm pjesëmarrjen e autorëve në punime shkencore.

Publikimi në revista të dyshimta


7 profesorë kanë 10 punime në 9 revista të dyshimta. 4 nga ta bëjnë pjesë në grupin e profesorëve që i justifikojnë titujt akademikë, ndërsa 3 nga grupi i profesorëve që nuk i justifikojnë titujt akademikë.

Profesorët e Fakultetit Filozofik kanë gjithsej 10 pjesëmarrje në publikimin e punimeve në 9 revista të dyshimta.

Për autor të parë ose korrespondent në intervalin kohor 2013-2017[29] përfshirja në publikim mbërrin në 8 pjesëmarrje.

Viti me më së shumti përfshirje të autorëve në publikimin e punimeve në revista të dyshimta është viti 2013, gjatë të cilit janë 4 pjesëmarrje.

Publikimi në revista të dyshimta



29 Punimi i parë në Fakultetin Filozofik i regjistruar në një revistë që nuk i plotëson kriteret është në vitin 2013, ndërsa i fundit në 2017.

METODOLOGJIA

Për shqyrtimin e revistave shkencore të punimeve të publikuara të stafit akademik në Universitetin e Prishtinës

Kriteret dhe parimet e përgjithshme për konsiderimin e revistave shkencore

Baza ligjore

1. Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës[30]
2. Statuti i Universitetit të Prishtinës (UP), gjegjësisht Nenet 175, 176 dhe 177.[31]
3. Udhëzimi Administrativ 01/2018 Parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension[32]
4. Udhëzimi Administrativ për plotësimin dhe precizimin – (Aneksi –I- MASHT) 7/2018 e Udhëzimit Administrativ 01/2018 Parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension.[33]
5. Rregullorja 465 për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina".[34]

ORCA ka bërë shqyrtimin e publikimeve në revista shkencore ndërkombëtare, të përcaktuara si kriter nga Ligji për Arsimin e Lartë në Kosovë, Statuti i UP-së për zgjedhje në njërin nga titujt akademikë: profesor asistent, profesor i asocuar apo profesor i rregullt, Udhëzimet Administrative 01/2018 dhe 07/2018, si dhe Rregullorja 465 e Universitetit të Prishtinës. Ky kriter siguron aktivitetin e vazhdueshëm shkencor, i cili është kyç në përvetësimin e metodave dhe rezultateve bashkëkohore, mbi të cilat garantohet mësimdhënia dhe kontributi i qëndrueshëm shkencor.

Objekti i shqyrtimit

Janë shqyrtuar 465 CV të stafit akademik me marrëdhënie të rregullt pune në 12 fakultetet e Universitetit të Prishtinës. Këtu nuk përfshihen asistentët, ligjëruesit, lektorët dhe bashkëpunëtorët e tjerë të cilët nuk i kanë titujt akademikë profesor asistent, profesor i asocuar apo profesor i rregullt.

Për arsye të natyrës specifike të tyre, ORCA nuk e ka bërë shqyrtimin e punimeve artistike të cilat kërkohen si kusht ekuivalent i publikimeve shkencore për Fakultetin e Arteve. Rrjedhimisht, profesorët e Fakultetit të Arteve nuk janë pjesë në raportin e ORCA-s.

30 https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2761

31 http://fiek.uni-pr.edu/Files/Dokumente/Relevante/Statutiversioniifundit.aspx

32 Udhëzimi Administrativ 01/2018 Parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension: http://masht.rks-gov.net/uploads/2018/01/ua-nr-01-2018-parimet-e-njohjes-se-platoformave-dhe-revistave-nderkombetare-me-recension.pdf

33 Udhëzimi Administrativ për plotësimin dhe precizimin – (Aneksi –I- MASHT) 7/2018 e Udhëzimit Administrativ 01/2018 Parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension: http://masht.rks-gov.net/uploads/2018/05/ua-7-2018-per-plotesimin-dhe-precizimin-e-ua-parimet-e-njohjes-per-revistat-nderkombetare_1.pdf

34 Rregullorja 465 për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina": https://www.uni-pr.edu/desk/inc/media/C15E46D5-5159-4E97-B8CB-D69734E39CA4.pdf

Periudha e mbledhjes së materialit për hulumtim

Të gjitha CV-të e shqyrtuara janë marrë në uebfaqen zyrtare të UP-së uni-pr.edu[35], gjatë periudhës së hulumtimit prej datës 01.05.2018 deri më 17.08.2018. Për arsye të saktësisë së të dhënave, këto CV i janë nënshtruar rishqyrtimit gjatë intervalit kohor 20.08.2018 deri më 31.08.2018. Të gjitha ndryshimet që janë evidentuar gjatë rishqyrtimit janë aplikuar përshtatshmërisht në bazën e të dhënave të hulumtimit mbi të cilin është ndërtuar ky raport.

Shqyrtimet e revistave

Duke u bazuar në UA1/2018, UA7/2018 dhe Rregulloren 465 të UP-së, ORCA ka vendosur koeficiente për secilin punim. Këto koeficiente janë vendosur përkatësisht sipas databazave ku janë të indeksuara revistat me koeficientet 1, 0.85 apo 0.70, apo sipas revistave të listuara në rregullativat e përmendura me koeficient 0.55.

ORCA i ka barasvlerësuar me koeficient 0 punimet e publikuara në përmbledhje konferencash, raportet, projektet, librat apo kapituj librash të cilat nuk janë revista shkencore ndërkombëtare, si dhe punimet të cilat janë në proces të publikimit, apo punimet për të cilat autorët kanë marrë çfarëdo konfirmimi nga revista përkatëse, por që nuk janë publikuar.

Publikimet në revista shkencore të vendeve fqinje, sipas UA 7/2018 duhet të jenë të indeksuara të paktën në njërën nga databazat indeksuese akademike Scopus apo Web of Science për të pasur koeficient.

Sipas UA 7/2018, revistat nga shkencat e Albanologjisë që janë vendore apo të Shqipërisë barasvlerësohen me koeficient vetëm nëse kanë redaksi ndërkombëtare.

Sipas UA 1/2018, punimet e publikuara në revistat që janë pjesë e listave të revistave të dyshimta apo që këto revista i kanë botuesit pjesë të listave të botuesve të dyshimtë, barasvlerësohen me koeficientin 0; përjashtimisht vetëm në rastet kur këto revista kanë qenë të indeksuara në njërën nga databazat indeksuese akademike Scopus apo Web of Science në kohën e publikimit të punimit. Si lista të revistave dhe botuesve të dyshimtë, sipas Rregullores 465 të UP-së, janë marrë listat e profesorit Jeffrey Beall.

Shqyrtimi individual dhe kolektiv nga hulumtuesit

Secilit hulumtues i janë ndarë numër i caktuar i CV-ve në mënyrë rastësore. Secili hulumtues ka shqyrtuar nëse revista në të cilën ka qenë punimi i publikuar është e indeksuar në njërën nga platformat indeksuese, sipas rregullativave në fuqi, dhe nëse revista ose botuesi i revistës është në listën e Beall-it.

Të dhënat e nxjerra nga shqyrtimi janë vendosur në tabela të standardizuara nga ku ka vazhduar shqyrtimi i mëtejmë kolektiv.

35 http://www.uni-pr.edu/

PËRFUNDIME

Universiteti i Prishtinës ka numër të vogël të punimeve të publikuara në revista shkencore. 55% e profesorëve të Universitetit të Prishtinës kanë së paku një punim të publikuar në revistë shkencore me koeficient. Ndërkohë që 208 profesorët e tjerë nuk e kanë asnjë punim shkencor të publikuar në revistë shkencore me koeficient.

Fakultetet e shkencave ekzakte kanë shumë më shumë punime të publikuara nga profesorët e tyre në revista shkencore, në krahasim me fakultetet e shkencave sociale dhe humanistike.

Bashkëpunimi në publikim, si në revista të mirëfillta, po ashtu në ato të dyshimta, është i vogël ndërmjet profesorëve të Universitetit të Prishtinës.

Publikimi në revistat e dyshimta është dukuri në Universitetin e Prishtinës. 33% të të gjithë profesorëve kanë publikuar të paktën 1 herë në revista të dyshimta.

JUSTIFIKIMI I TITUJVE AKADEMIKË TË PROFESORËVE NË UNIVERSITETIN E PRISHTINËS

Publikues:
ORCA – Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim
www.orca-ks.org
info@orca-ks.org
Simon Shiroka, H-11, Nr. 8
Prishtina, 10000, Kosova

Autore:
Adea Kondirolli

Editor:
Rron Gjinovci

Hulumtuesit:
Adea Kondirolli, Durim Jasharaj,
Gramos Buçinca, Robert Pajaziti, Venera Çoçaj

Prishtinë, tetor 2018

HYRJE

Pas raportit të ORCA-s “Integriteti akademik i profesorëve të Universitetit të Prishtinës”, në të cilin u shqyrtuan 481 profesorë në Universitetin e Prishtinës dhe u zbulua se 72% e profesorëve nuk i justifikojnë titujt, ORCA vendosi ta vazhdojë këtë hulumtim për të parë nëse ka përmirësime në justifikimin e titujve nga profesorët e UP-së.

ORCA ka paraqitur këtu një analizë të hollësishme mbi atë se sa i justifikojnë titujt që mbajnë profesorët në rast se do t’u nënshtroheshin procesit të vlerësimit sipas dispozitave në fuqi, të cilat burojnë nga Statuti i UP-së dhe Ligji për Arsimin e Lartë në Kosovë.

Pavarësisht faktit se dispozitat ligjore janë zbutur sa u përket kritereve të pranimit të një reviste ndërkombëtare, 59% e profesorëve të Universitetit të Prishtinës nuk arrijnë t’i justifikojnë titujt aktualë akademikë.

METODOLOGJIA E SHQYRTIMIT TË JUSTIFIKIMIT TË TITUJVE

Janë shqyrtuar 465 CV të stafit akademik me marrëdhënie të rregullt pune në 12 fakultetet e Universitetit të Prishtinës. Këtu nuk përfshihen asistentët, ligjëruesit, lektorët dhe bashkëpunëtorët e tjerë të cilët nuk i kanë titujt akademikë profesor asistent, profesor i asocuar apo profesor i rregullt.

Për arsye të natyrës specifike të tyre, ORCA nuk e ka bërë shqyrtimin e punimeve artistike të cilat kërkohen si kusht ekuivalent i publikimeve shkencore për Fakultetin e Arteve.

Rrjedhimisht, profesorët e Fakultetit të Arteve nuk janë pjesë në raportin e ORCA-s. Pavarësisht kohës së marrjes së titullit akademik, ORCA e ka shqyrtuar justifikimin e titujve vetëm krahas kritereve të përcaktuara me aktet aktuale juridike.

Ndonëse është e qartë që disa nga profesorët i kanë marrë titujt akademikë në kohën kur ka pasur dispozita të tjera në fuqi, ORCA ka tentuar ta paraqesë gjendjen aktuale të punimeve të publikuara në revista shkencore që i përmbushin kriteret dhe parimet e përcaktuara në këtë metodologji.

Për pozitën profesor asistent, profesori duhet ta ketë të botuar të paktën një punim shkencor në revista shkencore ndërkombëtare me recension, relevante sipas rregullativave në fuqi, si autor i parë apo korrespondent.[36]

Për pozitën profesor të asocuar, personi duhet t'i ketë të botuara të paktën tri punime shkencore në revista shkencore ndërkombëtare, relevante sipas rregullativave në fuqi, si autor i parë apo korrespondent.[37]

Për pozitën profesor të rregullt, personi duhet t'i ketë të botuara të paktën pesë punime shkencore në revista shkencore ndërkombëtare, relevante sipas rregullativave në fuqi, si autor i parë apo korrespondent.[38]

36 Neni 173, pika 1.2.1 e statutit të UP-së

37 Neni 174, pika 1.2.1 e statutit të UP-së

38 Neni 175, pika 1.2.1 e statutit të UP-së

TË DHËNAT E PËRGJITHSHME

Janë analizuar:

162 profesorë asistentë

165 profesorë të asocuar

138 profesorë të rregullt

Total: 465 profesorë

Justifikimi i titujve

Nga 465 profesorë, 189 (41%) i justifikojnë titujt sipas kriterit të punimeve shkencore në revista me koeficient. Kurse 276 (59%) nuk i justifikojnë titujt sipas kriterit të punimeve shkencore në revista me koeficient. Në hulumtimin e vitit 2017, 72% të profesorëve nuk kanë justifikuar titujt, ndërsa 28% kanë justifikuar.

Nga 189 profesorë që i justifikojnë titujt, 98 janë profesorë asistentë, 58 profesorë të asocuar dhe vetëm 33 profesorë të rregullt.

Ndërsa nga 276 profesorë që nuk i justifikojnë titujt, 64 janë profesorë asistentë, 107 profesorë të asocuar dhe 105 profesorë të rregullt.

208 nga 465 profesorë nuk e kanë asnjë punim shkencor në revista shkencore me koeficient (45%).

Krahasuar përbrenda grupeve përkatëse (prof. asistentë, prof. asocuar, prof. rregullt), justifikim më të madh të titujve kanë profesorët asistentë me 60%, ndërsa justifikim më të vogël të titujve kanë profesorët e rregullt me 24%.

105 profesorët e rregullt që nuk i justifikojnë titujt e tyre akademikë kanë të nënshkruara kontrata për kohë të pacaktuar me Universitetin e Prishtinës (UP), që do të thotë se ata nuk i detyrohen më UP-së sa i përket punës shkencore.

Aneks 1. *Tabela e të dhënave të përgjithshme sipas fakulteteve*

Nr.	Fakultetet në UP	profesorë që i justifikojnë titujt			profesorë që nuk i justifikojnë titujt		
		Prof. ass.	Prof. asoc.	Prof. rreg.	Prof. ass.	Prof. asoc.	Prof. rreg.
1	Fakulteti Filozofik	10	2	0	4	9	7
2	Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore	22	10	12	2	9	10
3	Fakulteti i Filologjisë	4	5	0	7	16	7
4	Fakulteti Juridik	5	8	2	8	6	13
5	Fakulteti Ekonomik	6	9	2	5	10	12
6	Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës	6	0	1	6	7	3
7	Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike	5	4	0	2	4	6
8	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	3	5	3	5	4	9
9	Fakulteti i Mjekësisë	17	9	7	11	21	22
10	Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë	9	3	5	1	7	8
11	Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit	1	0	0	2	7	4
12	Fakulteti i Edukimit	10	3	1	11	7	4
TOTAL		98	58	33	64	107	105
		189			276		

Fakulteti i Edukimit

36 profesorë me tituj akademikë:

5 profesorë të rregullt

10 profesorë të asocuar

21 profesorë asistentë

Justifikimi i titujve

Prej 36 profesorëve me tituj akademikë, 14 (39%) i justifikojnë titujt, ndërkaq 22 (61%) nuk i justifikojnë. Në hulumtimin e vitit 2017, përqindja e justifikimit në këtë fakultet ka qenë 33%.

Në grupin e 14 profesorëve që i justifikojnë titujt akademikë bëjnë pjesë 1 profesor i rregullt, 3 profesorë të asocuar dhe 10 profesorë asistentë.

Në grupin e 22 profesorëve që nuk i justifikojnë titujt bëjnë pjesë 4 profesorë të rregullt, 7 profesorë të asocuar dhe 11 profesorë asistentë.

I justifikojnë titujt			Nuk i justifikojnë titujt			TOTAL		
PROF. DR.	1	20%	**PROF. DR.**	4	80%	**PROF. DR.**	5	100%
PROF. ASOC.	3	30%	**PROF. ASOC.**	7	70%	**PROF. ASOC.**	10	
PROF. ASS.	10	48%	**PROF. ASS.**	11	52%	**PROF. ASS.**	21	

Fakulteti Ekonomik

44 profesorë me tituj akademikë:

14 profesorë të rregullt

19 profesorë të asocuar

11 profesorë asistentë

Justifikimi i titujve

Prej 44 profesorëve me tituj akademikë, 17 (38%) i justifikojnë titujt, ndërkaq 27 (62%) nuk i justifikojnë. Në hulumtimin e vitit 2017, përqindja e justifikimit në këtë fakultet ka qenë 31%.

Në grupin e 17 profesorëve që i justifikojnë titujt akademikë bëjnë pjesë 2 profesorë të rregullt, 9 profesorë të asocuar dhe 6 profesorë asistentë.

Në grupin e 31 profesorëve që nuk i justifikojnë titujt akademikë bëjnë pjesë 12 profesorë të rregullt, 10 profesorë të asocuar dhe 5 profesorë asistentë.

I justifikojnë titujt			Nuk i justifikojnë titujt			TOTAL		
PROF. DR.	2	14%	**PROF. DR.**	12	86%	**PROF. DR.**	14	100%
PROF. ASOC.	9	47%	**PROF. ASOC.**	10	53%	**PROF. ASOC.**	19	
PROF. ASS.	6	54%	**PROF. ASS.**	5	46%	**PROF. ASS.**	11	

Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë (FBV)

33 profesorë me tituj akademikë:

13 profesorë të rregullt

10 profesorë të asocuar

10 profesorë asistentë

Justifikimi i titujve

Prej 33 profesorëve me tituj akademikë, 17 (51%) i justifikojnë titujt, ndërkaq 16 (49%) nuk i justifikojnë. Në hulumtimin e vitit 2017, përqindja e justifikimit në këtë fakultet ka qenë 45%.

Në grupin e 17 profesorëve që i justifikojnë titujt akademikë bëjnë pjesë 5 profesorë të rregullt, 3 profesorë të asocuar dhe 9 profesorë asistentë.

Në grupin e 16 profesorëve që nuk i justifikojnë titujt akademikë bëjnë pjesë 8 profesorë të rregullt, 7 profesorë të asocuar dhe 1 profesor asistent.

I justifikojnë titujt			Nuk i justifikojnë titujt			TOTAL		
PROF. DR.	5	38%	**PROF. DR.**	8	62%	**PROF. DR.**	13	100%
PROF. ASOC.	3	30%	**PROF. ASOC.**	7	70%	**PROF. ASOC.**	10	
PROF. ASS.	9	90%	**PROF. ASS.**	1	10%	**PROF. ASS.**	10	

Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit (FEFS)

14 profesorë me tituj akademikë:

4 profesorë të rregullt

7 profesorë të asocuar

3 profesorë asistentë

Justifikimi i titujve

Prej 14 profesorëve me tituj akademikë, 1 (7%) e justifikon titullin, ndërkaq 14 (93%) nuk e justifikojnë. Në hulumtimin e vitit 2017, përqindja e justifikimit në këtë fakultet ka qenë 0%.

Profesori që justifikon titullin është profesor asistent.

Ky fakultet ka numrin më të madh të profesorëve që nuk i justifikojnë titujt akademikë.

I justifikojnë titujt			Nuk I justifikojnë titujt			TOTAL		
PROF. DR.	0	0%	**PROF. DR.**	4	100%	**PROF. DR.**	4	100%
PROF. ASOC.	0	0%	**PROF. ASOC.**	7	100%	**PROF. ASOC.**	7	
PROF. ASS.	1	33.33%	**PROF. ASS.**	2	66.66%	**PROF. ASS.**	3	

Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (FIEK)

21 profesorë me tituj akademikë:

6 profesorë të rregullt

8 profesorë të asocuar

7 profesorë asistentë

Justifikimi i titujve

Prej 21 profesorëve me tituj akademikë, 9 (43%) i justifikojnë titujt, ndërkaq 12 (57%) nuk i justifikojnë. Në hulumtimin e vitit 2017, përqindja e justifikimit në këtë fakultet ka qenë 17%.

Në grupin e 9 profesorëve që i justifikojnë titujt akademikë bëjnë pjesë 4 profesorë të asocuar dhe 5 profesorë asistentë.

Në grupin e 12 profesorëve që nuk i justifikojnë titujt akademikë bëjnë pjesë 6 profesorë të rregullt, 4 profesorë të asocuar dhe 2 profesorë asistentë.

Ky fakultet ka shënuar përmirësim në justifikimin e titujve për arsye të: pensionimit të profesorëve të rregullt që nuk i justifikojnë titujt, përditësimit të CV-ve me punime të reja, si dhe ndryshimit të rregullativës.

I justifikojnë titujt			Nuk i justifikojnë titujt			TOTAL		
PROF. DR.	0	0%	**PROF. DR.**	6	100%	**PROF. DR.**	6	100%
PROF. ASOC.	4	17%	**PROF. ASOC.**	4	83%	**PROF. ASOC.**	8	
PROF. ASS.	5	38%	**PROF. ASS.**	2	63%	**PROF. ASS.**	7	

Fakulteti i Filologjisë

39 profesorë me titulj akademikë:

7 profesorë të rregullt

21 profesorë të asocuar

11 profesorë asistentë

Justifikimi i titujve

Prej 39 profesorëve me titulj akademikë, 9 (23%) i justifikojnë titujt, ndërkaq 30 (73%) nuk i justifikojnë. Në hulumtimin e vitit 2017, përqindja e justifikimit në këtë fakultet ka qenë 10%.

Në grupin e 9 profesorëve që i justifikojnë titujt akademikë bëjnë pjesë 5 profesorë të asocuar dhe 4 profesorë asistentë.

Në grupin e 30 profesorëve që nuk i justifikojnë titujt akademikë bëjnë pjesë 7 profesorë të rregullt, 16 profesorë të asocuar dhe 7 profesorë asistentë.

Ndërkohë që nuk ka asnjë profesor të rregullt që justifikon titullin, janë 7 profesorë të rregullt të cilët nuk i justifikojnë titujt akademikë.

I justifikojnë titujt			Nuk i justifikojnë titujt			TOTAL		
PROF. DR.	0		**PROF. DR.**	7	100.00%	**PROF. DR.**	7	100%
PROF. ASOC.	5	29%	**PROF. ASOC.**	16	71%	**PROF. ASOC.**	21	
PROF. ASS.	4	36%	**PROF. ASS.**	7	64%	**PROF. ASS.**	11	

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike (FIM)

29 profesorë me titull akademikë:

12 profesorë të rregullt

9 profesorë të asocuar

8 profesorë asistentë

Justifikimi i titujve

Prej 29 profesorëve me titull akademikë, 11 (38%) i justifikojnë titujt, ndërkaq 18 (62%) nuk i justifikojnë. Në hulumtimin e vitit 2017, përqindja e justifikimit në këtë fakultet ka qenë 28%.

Në grupin e 11 profesorëve që i justifikojnë titujt akademikë bëjnë pjesë 3 profesorë të rregullt, 5 profesorë të asocuar dhe 3 profesorë asistentë.

Në grupin e 18 profesorëve që nuk i justifikojnë titujt akademikë bëjnë pjesë 9 profesorë të rregullt, 4 profesorë të asocuar dhe 5 profesorë asistentë.

I justifikojnë titujt			Nuk i justifikojnë titujt			TOTAL		
PROF. DR.	3	25%	**PROF. DR.**	9	75%	**PROF. DR.**	12	100%
PROF. ASOC.	5	55%	**PROF. ASOC.**	4	45%	**PROF. ASOC.**	9	
PROF. ASS.	3	37%	**PROF. ASS.**	5	63%	**PROF. ASS.**	8	

Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës (FNA)

23 profesorë me tituj akademikë:

4 profesorë të rregullt

7 profesorë të asocuar

12 profesorë asistentë

Justifikimi i titujve

Prej 23 profesorëve me tituj akademikë, 7 (30%) i justifikojnë titujt, ndërkaq 16 (70%) nuk i justifikojnë. Në hulumtimin e vitit 2017, përqindja e justifikimit në këtë fakultet ka qenë 18%.

Në grupin e 7 profesorëve që i justifikojnë titujt akademikë bëjnë pjesë 1 profesor i rregullt dhe 6 profesorë asistentë.

Në grupin e 16 profesorëve që nuk i justifikojnë titujt akademikë bëjnë pjesë 3 profesorë të rregullt, 7 profesorë të asocuar dhe 6 profesorë asistentë.

I justifikojnë titujt			Nuk i justifikojnë titujt			TOTAL		
PROF. DR.	1	25.00%	**PROF. DR.**	3	75%	**PROF. DR.**	4	100%
PROF. ASOC.	0	0.00%	**PROF. ASOC.**	7	100%	**PROF. ASOC.**	7	
PROF. ASS.	6	50%	**PROF. ASS.**	6	50%	**PROF. ASS.**	12	

Fakulteti i Shkencave Matematike – Natyrore (FShMN)

65 profesorë me tituj akademikë:

22 profesorë të rregullt

19 profesorë të asocuar

24 profesorë asistentë

Justifikimi i titujve

Prej 65 profesorëve me tituj akademikë, 44 (68%) i justifikojnë titujt, ndërkaq 21 (32%) nuk i justifikojnë. Në hulumtimin e vitit 2017, përqindja e justifikimit në këtë fakultet ka qenë 39%.

Në grupin e 44 profesorëve që i justifikojnë titujt akademikë bëjnë pjesë 12 profesorë të rregullt, 10 profesorë të asocuar dhe 22 profesorë asistentë.

Në grupin e 21 profesorëve që nuk i justifikojnë titujt akademikë bëjnë pjesë 10 profesorë të rregullt, 9 profesorë të asocuar dhe 2 profesorë asistentë.

I justifikojnë titujt			Nuk i justifikojnë titujt			TOTAL		
PROF. DR.	12	55.00%	**PROF. DR.**	10	45.00%	**PROF. DR.**	22	100%
PROF. ASOC.	10	53.00%	**PROF. ASOC.**	9	47.00%	**PROF. ASOC.**	19	
PROF. ASS.	22	92.00%	**PROF. ASS.**	2	8.00%	**PROF. ASS.**	24	

Fakulteti Juridik

42 profesorë me titull akademikë:

14 profesorë të rregullt

14 profesorë të asocuar

13 profesorë asistentë

Justifikimi i titujve

Prej 40 profesorëve me titull akademikë, 15 (36%) i justifikojnë titujt akademikë, ndërkaq 27 (64%) nuk i justifikojnë titujt akademikë. Në hulumtimin e vitit 2017, përqindja e justifikimit në këtë fakultet ka qenë 23%.

Në grupin e 15 profesorëve që i justifikojnë titujt akademikë bëjnë pjesë 2 profesorë të rregullt, 8 profesorë të asocuar dhe 5 profesorë asistentë.

Në grupin e 27 profesorëve që nuk i justifikojnë titujt akademikë bëjnë pjesë 13 profesorë të rregullt, 6 profesorë të asocuar dhe 8 profesorë asistentë.

I justifikojnë titujt			Nuk i justifikojnë titujt			TOTAL		
PROF. DR.	2	13%	**PROF. DR.**	13	87%	**PROF. DR.**	15	100%
PROF. ASOC.	8	57%	**PROF. ASOC.**	6	43%	**PROF. ASOC.**	14	
PROF. ASS.	5	38%	**PROF. ASS.**	8	62%	**PROF. ASS.**	13	

Fakulteti i Mjekësisë

87 profesorë me tituj akademikë:

29 profesorë të rregullt

30 profesorë të asocuar

28 profesorë asistentë

Justifikimi i titujve

Prej 87 profesorëve me tituj akademikë, 33 (38%) i justifikojnë titujt akademikë, ndërkaq 54 (62%) nuk i justifikojnë titujt akademikë. Në hulumtimin e vitit 2017, përqindja e justifikimit në këtë fakultet ka qenë 34%.

Në grupin e 33 profesorëve që i justifikojnë titujt akademikë bëjnë pjesë 7 profesorë të rregullt, 9 profesorë të asocuar dhe 17 profesorë asistentë.

Në grupin e 54 profesorëve që nuk i justifikojnë titujt akademikë bëjnë pjesë 22 profesorë të rregullt, 21 profesorë të asocuar dhe 11 profesorë asistentë.

I justifikojnë titujt			Nuk i justifikojnë titujt			TOTAL		
PROF. DR.	7	24%	**PROF. DR.**	22	76%	**PROF. DR.**	29	100%
PROF. ASOC.	9	30%	**PROF. ASOC.**	21	70%	**PROF. ASOC.**	30	100%
PROF. ASS.	17	62%	**PROF. ASS.**	11	38%	**PROF. ASS.**	28	100%

Fakulteti Filozofik

32 profesorë me tituj akademikë:

7 profesorë të rregullt

11 profesorë të asocuar

14 profesorë asistentë

Justifikimi i titujve

Prej 32 profesorëve me tituj akademikë, 12 (37%) i justifikojnë titujt akademikë, ndërkaq 20 (63%) nuk i justifikojnë titujt akademikë. Në hulumtimin e vitit 2017, përqindja e justifikimit në këtë fakultet ka qenë 25%.

Në grupin e 12 profesorëve që i justifikojnë titujt akademikë bëjnë pjesë 2 profesorë të asocuar dhe 10 profesorë asistentë.

Në grupin e 20 profesorëve që nuk i justifikojnë titujt akademikë bëjnë pjesë 7 profesorë të rregullt, 9 profesorë të asocuar dhe 4 profesorë asistentë.

I justifikojnë titujt			Nuk i justifikojnë titujt			TOTAL		
PROF. DR.	0	0	**PROF. DR.**	7	100%	**PROF. DR.**	7	100%
PROF. ASOC.	2	18.18%	**PROF. ASOC.**	9	81.82%	**PROF. ASOC.**	11	
PROF. ASS.	10	71.42%	**PROF. ASS.**	4	28.58%	**PROF. ASS.**	14	

ANALIZA E KONKURSIT PËR ZGJEDHJEN E PERSONELIT AKADEMIK MËSIMDHËNËS NË UNIVERSITETIN E PRISHTINËS 2018

Publikues:
ORCA – Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim
www.orca-ks.org
info@orca-ks.org
Simon Shiroka, H-11, Nr. 8
Prishtina, 10000, Kosova

Autore:
Adea Kondirolli

Hulumtuesit:
Adea Kondirolli, Durim Jasharaj,
Gramos Buçinca, Venera Çoçaj

Prishtinë, gusht 2018

HYRJE

Duke konsideruar faktin që 72% e profesorëve ekzistentë të Universitetit të Prishtinës nuk i justifikojnë titujt e tyre sipas ligjeve në fuqi, ORCA ka vazhduar hulumtimin e buletineve të aplikimeve të profesorëve për emërim, riemërim, apo avancim në tituj akademikë në UP, në mënyrë që profesorët të cilët nuk i përmbushin kriteret të mos bëhen pjesë e Universitetit.

Për të mos e lënë këtë proces vetëm në aspektin e hulumtimit të aplikimeve, ORCA gjithashtu monitoron votimet e Senatit për kandidatët, duke u kujdesur që të reagojë për çdo avancim jomeritor.

Kjo analizë vjen si përmbyllje e procesit të hulumtimit të ORCA-s për konkursin 1-173 të datës 27.04.2018 për zgjedhjen e personelit akademik në Universitetin e Prishtinës.

Në këtë proces, ORCA ka vënë re një përmirësim të dukshëm të përmbushjes së kriterit të punimeve shkencore nga profesorët e Universitetit të Prishtinës. Kjo vjen edhe si rrjedhojë e precizimit të kritereve përmes Udhëzimit Administrativ 01/2018 dhe 07/2018, si dhe Rregullores 465 për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”.

Nga 199 kandidatët e shqyrtuar nga ORCA, 153 plotësojnë kriteret për t’u zgjedhur, rizgjedhur ose avancuar si staf akademik. Në përqindje kjo shprehet në 77%. Vitin e kaluar kjo përqindje ka qenë 45%, që tregon një përmirësim të dukshëm në përmbushjen e kritereve ekzistuese.

ORCA konsideron se mënyra ekzistuese e emërimit, riemërimit dhe avancimit të stafit lë shumë hapësirë për interpretime, korrupsion, nepotizëm, klientelizëm, dhe që një mënyrë për ta bërë procesin transparent dhe meritokratik është themelimi i një autoriteti qendror me pjesëmarrje ndërkombëtare që verifikon, unifikon dhe dhuron titujt akademikë.

METODOLOGJIA

ORCA ka bërë shqyrtimin e publikimeve në revista shkencore ndërkombëtare të kandidatëve për mësimdhënës të vlerësuar pozitivisht nga komisionet vlerësuese përkatëse. Publikime këto, të përcaktuara si kriter nga Ligji për Arsimin e Lartë në Kosovë, Statuti i UP-së për zgjedhje në njërin nga titujt akademikë: profesor asistent, profesor i asocuar apo profesor i rregullt. Ky kriter siguron aktivitetin e vazhdueshëm shkencor, i cili është kyç në përvetësimin e metodave dhe rezultateve bashkëkohore, mbi të cilat garantohet mësimdhënia dhe kontributi i qëndrueshëm shkencor.

Baza ligjore

Për shqyrtimin e revistave shkencore të punimeve të publikuara të kandidatëve në Universitetin e Prishtinës janë marrë parasysh:

1. Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës[39]
2. Statuti i Universitetit të Prishtinës (UP), gjegjësisht Nenet 175, 176 dhe 177[40]
3. Udhëzimi Administrativ 01/2018 Parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension[41]
4. Udhëzimi Administrativ për plotësimin dhe precizimin – (Aneksi –I- MASHT) 7/2018 e Udhëzimit Administrativ 01/2018 Parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension[42]
5. 465 për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”[43]

39 Ligji Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2761

40 Statuti i Universitetit të Prishtinës: http://fiek.uni-pr.edu/Files/Dokumente/Relevante/Statutiversioniifundit.aspx

41 Udhëzimi Administrativ 01/2018 Parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension: http://masht.rks-gov.net/uploads/2018/01/ua-nr-01-2018-parimet-e-njohjes-se-platoformave-dhe-revistave-nderkombetare-me-recension.pdf

42 Udhëzimi Administrativ për plotësimin dhe precizimin – (Aneksi –I- MASHT) 7/2018 e Udhëzimit Administrativ 01/2018 Parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension: http://masht.rks-gov.net/uploads/2018/05/ua-7-2018-per-plotesimin-dhe-precizimin-e-ua-parimet-e-njohjes-per-revistat-nderkombetare_1.pdf

43 Rregullorja 465 për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”: https://www.uni-pr.edu/desk/inc/media/C15E46D5-5159-4E97-B8CB-D69734E39CA4.pdf

Për pozitën profesor asistent, kandidatët duhet të kenë të publikuar të paktën një punim shkencor në revista shkencore ndërkombëtare me recension, relevante sipas Statutit të UP-së, si autor të parë apo korrespondent. Rrjedhimisht, sipas rregullativave aktuale, koeficientin e publikimeve duhet ta kenë 1.

Për pozitën profesor të asocuar kandidatët duhet të kenë të publikuar të paktën tri punime shkencore në revista shkencore ndërkombëtare relevante, sipas Statutit të UP-së, si autor të parë apo korrespondent. Rrjedhimisht, sipas rregullativave aktuale, koeficientin e publikimeve duhet ta kenë 3.

Për pozitën profesor të rregullt, kandidatët duhet të kenë të publikuar të paktën pesë punime shkencore në revista shkencore ndërkombëtare relevante, sipas Statutit të UP-së, si autor të parë apo korrespondent. Rrjedhimisht, sipas rregullativave aktuale, koeficientin e publikimeve duhet ta kenë 5.

Objekti i shqyrtimit

ORCA ka shqyrtuar publikimet shkencore të të gjithë kandidatëve të cilët janë vlerësuar pozitivisht për emërim, riemërim apo avancim nga komisionet e tyre vlerësuese.

Të gjithë kandidatët e shqyrtuar janë marrë nga buletinet e publikuara në uebfaqen zyrtare të Universitetit të Prishtinës (UP) – uni-pr.edu[44], gjatë periudhës 24.05.2018 deri më 17.07.2018. Këto buletine përmbajnë të dhënat zyrtare të aplikacionit të secilit kandidat, sipas formës së kërkuar nga Senati i UP-së, si dhe paraqesin dëshminë me shkrim të vlerësimeve të komisioneve vlerësuese për secilin prej këtyre kandidatëve.

Publikimet shkencore janë të listuara në pikën A "Publikime në revista ndërkombëtare shkencore në frymën e nenit 175, 176 dhe 177 të Statutit të UP-së, në pajtim me Rregulloren Nr.465", tabelën II.1 "Numri i publikimeve si autor i parë dhe si autor korrespondent", nga komisionet përkatëse vlerësuese.

Për arsye të natyrës specifike të tyre, ORCA nuk ka bërë shqyrtimin e punimeve artistike të cilat kërkohen si kusht ekuivalent i publikimeve shkencore për Fakultetin e Arteve. Rrjedhimisht, kandidatët për mësimdhënie në Fakultetin e Arteve nuk janë pjesë në raportin e ORCA-s.

Shqyrtimet e revistave

Duke u bazuar në UA1/2018, UA7/2018 dhe Rregulloren 465 të UP-së, ORCA ka vendosur koeficiente për secilin publikim të listuar në tabelën A II.1. Këto koeficiente janë vendosur përkatësisht sipas databazave ku janë të indeksuara revistat me koeficientet 1, 0.85 apo 0.70, apo sipas revistave të listuara në rregullativat e përmendura me koeficient 0.55.

ORCA i ka barasvlerësuar me koeficient 0 punimet e publikuara në përmbledhje konferencash, raportet, projektet, librat apo kapituj librash të cilat nuk janë revista shkencore ndërkombëtare, si dhe punimet të cilat janë në proces të publikimit, apo punimet për të cilat autorët kanë marrë çfarëdo konfirmimi nga revista përkatëse, por që nuk janë publikuar.

Publikimet në revista shkencore të vendeve fqinje, sipas UA 7/2018 duhet të jenë të indeksuara në të paktën njërën nga databazat indeksuese akademike Scopus apo Web of Science për të pasur koeficient. Sipas UA 7/2018, revistat nga shkencat e Albanologjisë që janë vendore apo të Shqipërisë barasvlerësohen me koeficient vetëm nëse kanë redaksi ndërkombëtare.

Sipas UA 1/2018, punimet e publikuara në revistat që janë pjesë e listave të revistave të dyshimta apo që i kanë botuesit pjesë të listave të botuesve të dyshimtë, barasvlerësohen me koeficientin 0; përjashtimisht vetëm në rastet kur këto revista kanë qenë të indeksuara në njërën nga databazat indeksuese akademike Scopus apo Web of Science në kohën e publikimit të punimit. Si lista të revistave dhe botuesve të dyshimtë, sipas Rregullores 465 të UP-së, janë marrë listat e profesorit Jeffrey Beall.

44 Buletinet UP: https://www.uni-pr.edu/page.aspx?id=1,54

REZULTATET E PËRGJITHSHME

Nga 26 buletinet e shpallura nga Universiteti i Prishtinës, ORCA ka shqyrtuar 23 (duke përjashtuar buletinet nga Fakulteti i Arteve). Në këto 23 buletine janë rekomanduar pozitivisht 200 kandidatë nga komisionet vlerësuese.

Nga 200 kandidatë, 53 kanë kandiduar për pozitën profesor i rregullt, 63 kanë kandiduar për pozitën profesor i asocuar dhe 83 kanë kandiduar për pozitën profesor asistent. Një kandidat nga Fakulteti i Edukimit është nga fusha e arteve figurative, prandaj nuk merr pjesë në analizë.

Nga 199 kandidatët, 153 i plotësojnë kriteret për t'u zgjedhur, rizgjedhur ose avancuar si staf akademik. Në përqindje kjo shprehet në 77%. Vitin e kaluar kjo përqindje ka qenë 45%, që tregon një përmirësim të dukshëm në përmbushjen e kritereve ekzistuese.

Rezultatet e përgjithshme të hulumtimit			
Titulli akademik	**Numri i kandidatëve**	**Pozitiv nga ORCA**	**Negativ nga ORCA**
Profesor i rregullt	53	33	20
Profesor i asocuar	63	47	16
Profesor asistent	83	73	10
Total	199	153	46

Tabela 1. *Rezultatet e përgjithshme të hulumtimit të ndarë sipas gradave dhe vlerësimit të ORCA-s*

Profesorët e UP-së			
Fakulteti	**Meritorë**	**Jomeritorë**	**Total**
Fakulteti Filozofik	7	5	12
Fakulteti i Shkencave Matematiko – Natyrore	21	6	27
Fakulteti i Filologjisë	9	7	16
Fakulteti Juridik	7	2	9
Fakulteti Ekonomik	8	2	10
Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës	12	5	17
Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Komp-juterike	8	1	9
Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	11	0	11
Fakulteti i Mjekësisë	53	9	62
Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë	12	4	16
Fakulteti i Edukatës Fizike dhe i Sportit	1	3	4
Fakulteti i Edukimit	4	2	6
Total	153	46	199

Tabela 2. *Rezultatet e përgjithshme të hulumtimit të ndarë sipas fakulteteve dhe vlerësimit të ORCA-s*

Punimet e paraqitura nga profesorët			
Fakulteti	**Punimet që kanë koeficient**	**Punimet që nuk kanë koeficient**	**Total**
Fakulteti Filozofik	18	44	62
Fakulteti i Shkencave Matematiko – Natyrore	158	77	235
Fakulteti i Filologjisë	46	48	94
Fakulteti Juridik	47	24	71
Fakulteti Ekonomik	42	15	57
Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës	34	10	44
Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike	27	10	37
Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	118	7	125
Fakulteti i Mjekësisë	207	73	280
Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë	50	33	83
Fakulteti i Edukatës Fizike dhe i Sportit	3	14	17
Fakulteti i Edukimit	9	14	23
Total	759	369	1128

Tabela 3. *Numri i punimeve shkencore dhe punimeve që nuk numërohen për këtë proces të ndara sipas fakulteteve*

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Mosplotësimi i kriterit të publikimeve shkencore nga kandidatët vazhdon të mbetet real edhe pas kritikave nga raporti i kaluar i ORCA-s dhe shqetësimeve të organizatave të tjera të shoqërisë civile.

Një numër i madh parregullsish janë shënuar te raportet e komisioneve vlerësuese në fakultete përkatëse për kandidatët e propozuar. Listimet e aktivitetit shkencor kanë qenë në raste të shumta të gabuara. P.sh. në rastet kur punimi ka qenë kontribut në libër është paraqitur si publikim shkencor në revistë shkencore; apo rastet e pjesëmarrjes në konferenca janë listuar po ashtu si publikime shkencore në revista shkencore. Komisionet vlerësuese gjithashtu kanë pranuar punime që nuk janë botuar ende, edhe pse rregullorja 465, neni 6, thotë që punimet duhet të jenë të botuara në kohën e aplikimit.

Shqetësim të veçantë përbëjnë rastet kur anëtarët e komisionit vlerësues kanë vlerësuar punimin në të cilin dhe vetë kanë qenë koautor.

Komisionet vlerësuese aktuale janë të papranueshme dhe lënë shumë hapësirë për konflikt interesi, nepotizëm, klientelizëm. Një mënyrë për ta shmangur këtë do të ishte që komisionet vlerësuese të kenë pjesëmarrje ndërkombëtare.

Një mënyrë tjetër do ishte një autoritet qendror me pjesëmarrje ndërkombëtare që verifikon, unifikon dhe dhuron titujt akademikë.

Fakulteti Filozofik

Në buletinin nr. 3 të Fakultetit Filozofik, të shpallur më 30 maj 2018, janë rekomanduar pozitivisht nga komisionet vlerësuese 12 kandidatë. Nga këta 12 kandidatë, 2 kanë kandiduar për profesorë të rregullt, 2 për profesorë të asocuar dhe 8 për profesorë asistentë.

Nga 12 kandidatët e vlerësuar pozitivisht nga komisionet vlerësuese, ORCA ka vlerësuar vetëm 7 nga ta, të shpërndarë nëpër tituj akademikë.

Fakulteti Filozofik			
Titulli akademik i propozuar	**Numri i kandidatëve**	**Pozitiv nga ORCA**	**Negativ nga ORCA**
Profesor i rregullt	2	1	1
Profesor i asocuar	2	0	2
Profesor asistent	8	6	2
Total	12	7	5

Disa nga kandidatët e këtij fakulteti kanë kandiduar për lëndë që nuk kanë të bëjnë me Albanologji, por punimet i kanë të gjitha të fushës së Albanologjisë, ose të publikuara në revista të Albanologjisë. Këto punime nuk janë pranuar për asnjë kandidat që nuk i ka lëndët e fushës.

Gjithashtu, vlen të përmendet që nga 12 kandidatët e vlerësuar pozitivisht nga komisionet vlerësuese, vetëm 3 janë gra.

Fakulteti i Shkencave Matematiko – Natyrore

Në Fakultetin e Shkencave Matematiko – Natyrore (FShMN), në buletinet numër 4 dhe 5, të shpallur më 4 qershor 2018, janë rekomanduar pozitivisht nga komisionet vlerësuese 27 kandidatë. Nga këta 27 kandidatë, 10 kanë kandiduar për profesorë të rregullt, 11 për profesorë të asocuar dhe 6 për profesorë asistentë.

Për 1 pozitë janë vlerësuar pozitivisht 2 kandidatë; njëri kandidat është rekomanduar nga 2 anëtarë të komisionit dhe kandidati tjetër nga anëtari i tretë i komisionit.

Nga 27 kandidatët e vlerësuar pozitivisht nga komisionet vlerësuese, ORCA ka vlerësuar pozitivisht 21 nga ta, të shpërndarë nëpër tituj akademikë.

Fakulteti i Shkencave Matematiko – Natyrore			
Titulli akademik i propozuar	**Numri i kandidatëve**	**Pozitiv nga ORCA**	**Negativ nga ORCA**
Profesor i rregullt	10	7	3
Profesor i asocuar	11	10	1
Profesor asistent	6	4	2
Total	27	21	6

11 kandidatë të vlerësuar pozitivisht nga komisionet vlerësuese kanë publikuar të paktën një herë në revista të dyshimta.

Fakulteti i Filologjisë

Në Fakultetin e Filologjisë, në buletinin numër 7, të shpallur më 5 qershor 2018, dhe buletinin numër 15, të shpallur më 8 qershor 2018, janë rekomanduar pozitivisht nga komisionet vlerësuese 16 kandidatë. Prej tyre, 4 kanë kandiduar për profesorë të rregullt, 6 për profesorë të asocuar dhe 6 për profesorë asistentë.

Nga 16 kandidatët e vlerësuar pozitivisht nga komisionet vlerësuese, ORCA ka vlerësuar pozitivisht 9 nga ta, të shpërndarë nëpër tituj akademikë.

Fakulteti i Filologjisë			
Titulli akademik i propozuar	**Numri i kandidatëve**	**Pozitiv nga ORCA**	**Negativ nga ORCA**
Profesor i rregullt	4	2	2
Profesor i asocuar	6	3	3
Profesor asistent	6	4	2
Total	16	9	7

Disa nga kandidatët e këtij fakulteti kanë kandiduar për lëndë që nuk kanë të bëjnë me Albanologji, por punimet i kanë të gjitha të fushës së Albanologjisë, ose të publikuara në revista albanologjie. Këto punime nuk janë pranuar për asnjë kandidat që nuk i ka lëndët e fushës.

Gjithashtu, revistat "Studime – AShAK", "Studime Albanologjike", "Gjurmime Albanologjike", "Studime Filologjike" dhe "Symbol" janë revista vendore ose të vendeve fqinje dhe nuk janë të indeksuara në Scopus ose Web of Science. Gjithashtu, nuk kemi arritur të vërtetojmë që këto revista kanë redaksi ndërkombëtare, siç kërkohet nga UA1/2018 për revistat e fushës së albanologjisë.

Fakulteti Juridik

Në Fakultetin Juridik, në buletinin numër 20, të shpallur më 14 qershor 2018, buletinin 21, të shpallur më 20 qershor 2018, dhe buletinin numër 26, të shpallur më 17 korrik 2018, janë rekomanduar pozitivisht nga komisionet vlerësuese 9 kandidatë. Prej tyre, 6 kanë kandiduar për profesorë të rregullt, 2 për profesorë të asocuar dhe 1 për profesor asistent.

Nga 9 kandidatët e vlerësuar pozitivisht nga komisionet vlerësuese, ORCA ka vlerësuar pozitivisht 7 nga ta, të shpërndarë nëpër tituj akademikë.

Fakulteti Juridik			
Titulli akademik i propozuar	**Numri i kandidatëve**	**Pozitiv nga ORCA**	**Negativ nga ORCA**
Profesor i rregullt	6	5	1
Profesor i asocuar	2	1	1
Profesor asistent	1	1	0
Total	9	7	2

7 nga nëntë profesorët kanë publikuar të paktën një herë në revista të Acta Universitatis Danubius, disa prej të cilëve deri në dhjetë herë.

1 profesor i propozuar për titullin profesor i rregullt ka publikuar 16 herë në revista të dyshimta.

Fakulteti Ekonomik

Në Fakultetin Ekonomik, në buletinin numër 2, të shpallur më 28 qershor 2018, janë rekomanduar pozitivisht nga komisionet vlerësuese 10 kandidatë. Prej tyre, 4 kanë kandiduar për profesorë të rregullt dhe 6 për profesorë të asocuar.

Nga 10 kandidatët e vlerësuar pozitivisht nga komisionet vlerësuese, ORCA ka vlerësuar pozitivisht 8 nga ta, të shpërndarë nëpër tituj akademikë.

Fakulteti Ekonomik			
Titulli akademik i propozuar	**Numri i kandidatëve**	**Pozitiv nga ORCA**	**Negativ nga ORCA**
Profesor i rregullt	4	2	2
Profesor i asocuar	6	6	0
Profesor asistent	0	0	0
Total	10	8	2

3 nga 10 profesorët kanë publikuar të paktën 1 herë në revista të Acta Universitatis Danubius, disa prej të cilëve deri në 10 herë.

3 profesorë kanë publikuar në revista të dyshimta.

Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe i Arkitekturës

Në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës (FNA), në buletinin numër 8, të shpallur më 6 qershor 2018, dhe buletinin 25, të shpallur më 6 korrik 2018, janë rekomanduar pozitivisht nga komisionet vlerësuese 17 kandidatë. Prej tyre, njëri ka kandiduar për profesor të rregullt, 7 për profesorë të asocuar dhe 9 për profesorë asistentë.

Nga 17 kandidatët e vlerësuar pozitivisht nga komisionet vlerësuese, ORCA ka vlerësuar pozitivisht 12 nga ta, të shpërndarë nëpër tituj akademikë.

Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës			
Titulli akademik i propozuar	**Numri i kandidatëve**	**Pozitiv nga ORCA**	**Negativ nga ORCA**
Profesor i rregullt	1	0	1
Profesor i asocuar	7	4	3
Profesor asistent	9	8	1
Total	17	12	5

5 nga 9 kandidatët për profesorë asistentë janë mbi moshën 50-vjeçare, që, sipas rregullativave në fuqi, nuk lejohen të zgjedhen si staf akademik për herë të parë.

45 INTEGRITETI AKADEMIK I PROFESORËVE NË UNIVERSITETIN E PRISHTINËS, dhjetor 2017, linku: http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2017/12/Integriteti-akademik-i-profesoreve-ne-Universitetin-e-Prishtines.pdf

Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike

Në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (FIEK), në buletinin numër 9, të shpallur më 6 qershor 2018, janë rekomanduar pozitivisht nga komisionet vlerësuese 9 kandidatë. Njëri prej tyre ka kandiduar për profesor të rregullt, 4 për profesorë të asocuar dhe 4 për profesorë asistentë.

Nga 9 kandidatët e vlerësuar pozitivisht nga komisionet vlerësuese, ORCA ka vlerësuar pozitivisht 8 nga ta, të shpërndarë nëpër tituj akademikë.

Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike			
Titulli akademik i propozuar	**Numri i kandidatëve**	**Pozitiv nga ORCA**	**Negativ nga ORCA**
Profesor i rregullt	1	1	0
Profesor i asocuar	4	3	1
Profesor asistent	4	4	0
Total	9	8	1

3 nga profesorët kanë publikuar në 2 revista të dyshimta, të paraqitura nga ORCA në analizën e saj për Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike.

2 nga profesorët që kandidojnë për profesorë asistentë janë mbi moshën 50-vjeçare.

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike

Në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike (FIM), në buletinin numër 1, të shpallur më 24 maj 2018, janë rekomanduar pozitivisht nga komisionet vlerësuese 11 kandidatë. Prej tyre, 8 kanë kandiduar për profesorë të rregullt, 2 për profesorë të asocuar dhe 1 për profesor asistent.

Sikur komisionet vlerësuese, edhe ORCA ka vlerësuar pozitivisht 11 kandidatët, të shpërndarë nëpër tituj akademikë.

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike			
Titulli akademik i propozuar	**Numri i kandidatëve**	**Pozitiv nga ORCA**	**Negativ nga ORCA**
Profesor i rregullt	8	8	0
Profesor i asocuar	2	2	0
Profesor asistent	1	1	0
Total	11	11	0

Nga këta 11 kandidatë, 10 kanë publikuar 5-19 artikuj në revista shkencore brenda viteve 2017-2018, pra mesatarisht 5 punime në vit për person.

Revista e cila ka mundësuar botimet të shpejta dhe me frekuencë të lartë është International Journal of Mechanical Engineering and Technology me adresë në Indi, në të cilën 10 kandidatët kanë publikuar në total 40 herë, secili 3 deri në 6 herë brenda viteve 2017–2018, si autor i parë ose korrespondent. Kjo revistë është e indeksuar në Scopus, kurse publikuesi International Association of Engineering and Management Education (IAEME) figuron dhe në listën e Beall-it të publikuesve të dyshimtë. Kjo revistë botohet çdo muaj me mbi 150 punime në muaj. Disa nga punimet që ORCA i ka parë, duke përfshirë edhe punimet e profesorëve të FIM-it, janë me gabime drejtshkrimore në gjuhën angleze dhe kanë përmbajtje të njëjtë në disa pjesë të tyre. Këto dy praktika janë të papranueshme në revista të mirëfillta shkencore.

Në revistën ANNALS of Faculty Engineering Hunedoara– International Journal of Engineering të Romanisë, 5 nga 10 kandidatët në total kanë publikuar 12 punime, 10 nga ta si autor të parë apo korrespondent, secili 2 deri në 3 herë.

Kurse publikuesi nga Bulgaria, Scientific Technical Union of Mechanical Engineering , ka mundësuar që 7 nga 10 kandidatët të publikojnë në revistat e tij, gjithsej 22 punime, ku secili nga këta 7 kandidatë kanë publikuar 1 deri 5 herë si autor të parë ose korrespondent.

Edhe pse këto revista i përmbushin kriteret formale, mënyra e publikimeve në afat të shkurtër dhe me frekuencë të lartë e vë në dyshim serioz cilësinë e revistës. Revistat e mirëfillta shkencore kërkojnë kohë më të gjatë për publikimin e punimeve, sepse punimet i nënshtrohen procesit të shqyrtimit dhe recensionit. Është e rëndësishme që në Universitetin e Prishtinës të vendosen praktika institucionale për integritet të lartë akademik, sidomos në procesin e zgjedhjes së profesorëve, të cilat duhet të jenë në baza meritore. ORCA konsideron se ky lloj publikimi rapid e dëmton thellësisht Universitetin e Prishtinës, por edhe përçon mesazh të gabuar te studentët, që për arritjen e suksesit nuk nevojitet angazhim serioz shkencor në akademi.

Fakulteti i Mjekësisë

Në Fakultetin e Mjekësisë në buletinin numër 16, të shpallur më 12 qershor 2018; buletinin numër 17, të shpallur më 12 qershor 2018; buletinin numër 18, të shpallur më 13 qershor 2018; buletinin numër 21, të shpallur më 20 qershor 2018; buletinin numër 22, të shpallur më 22 qershor 2018; buletinin numër 23, të shpallur më 29 qershor 2018; buletinin numër 24, të shpallur më 6 korrik 2018; buletinin numër 25, të shpallur më 6 korrik 2018; dhe buletinin numër 26, të shpallur më 17 korrik 2018, janë rekomanduar pozitivisht nga komisionet vlerësuese 62 kandidatë.

Prej tyre, 9 kanë kandiduar për profesorë të rregullt, 17 për profesorë të asocuar dhe 36 për profesorë asistentë.

Te profesorët e asocuar, 2 kanë kandiduar për të njëjtën pozitë dhe njëri është rekomanduar nga 2 anëtarë komisioni, tjetri nga 1 anëtar komisioni.

Te profesorët asistentë, janë tri pozita në të cilat janë rekomanduar 5 kandidatë nga anëtarë të ndryshëm komisioni në të tri pozitat.

Për këto katër pozita (13 profesorë) do të vendoset në Këshill të Fakultetit të Mjekësisë ose në Senatin e UP-së.

Nga 62 kandidatët e vlerësuar pozitivisht nga komisionet vlerësuese, ORCA ka vlerësuar pozitivisht 53 nga ta, të shpërndarë nëpër tituj akademikë.

Fakulteti i Mjekësisë			
Titulli akademik i propozuar	**Numri i kandidatëve**	**Pozitiv nga ORCA**	**Negativ nga ORCA**
Profesor i rregullt	9	6	3
Profesor i asocuar	17	12	5
Profesor asistent	36	35	1
Total	62	53	9

Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë

Në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë (FBV), në buletinin numër 14, të shpallur më 8 qershor 2018, janë rekomanduar pozitivisht nga komisionet vlerësuese 16 kandidatë. Prej tyre, 4 kanë kandiduar për profesorë të rregullt, 5 për profesorë të asocuar dhe 7 për profesorë asistentë.

Dy kandidatë janë propozuar për të njëjtën pozitë, duke i dhënë përparësi kandidates femër, nëse asaj i botohet punimi para vendimit të senatit, përndryshe do të avancohet kandidati tjetër.

Nga 16 kandidatët e vlerësuar pozitivisht nga komisionet vlerësuese, ORCA ka vlerësuar pozitivisht 11 nga ta, të shpërndarë nëpër tituj akademikë.

Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë			
Titulli akademik i propozuar	**Numri i kandidatëve**	**Pozitiv nga ORCA**	**Negativ nga ORCA**
Profesor i rregullt	4	1	3
Profesor i asocuar	5	5	0
Profesor asistent	7	6	1
Total	16	12	4

Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit

Në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit, në buletinin numër 19, të shpallur më 14 qershor 2018, janë rekomanduar pozitivisht nga komisionet vlerësuese 4 kandidatë. Prej tyre, 3 kanë kandiduar për profesorë të rregullt dhe 1 për profesor asistent.

Dy nga kandidatët për profesorë të rregullt janë rekomanduar për rizgjedhje në pozitën profesor i asocuar.

Nga katër kandidatët e vlerësuar pozitivisht nga komisionet vlerësuese, ORCA ka vlerësuar pozitivisht një nga ta.

Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit			
Titulli akademik i propozuar	**Numri i kandidatëve**	**Pozitiv nga ORCA**	**Negativ nga ORCA**
Profesor i rregullt	3	0	3
Profesor i asocuar	0	0	0
Profesor asistent	1	1	0
Total	4	1	3

Fakulteti i Edukimit

Në Fakultetin e Edukimit, në buletinin numër 13, të shpallur më 8 qershor 2018, janë rekomanduar pozitivisht nga komisionet vlerësuese 7 kandidatë, prej të cilëve 1 ka kandiduar për profesor të rregullt, 2 për profesorë të asocuar dhe 4 për profesorë asistentë.

Një nga kandidatët është nga fusha e artit figurativ, prandaj, sipas metodologjisë, nuk është shqyrtuar nga ORCA.

Nga 6 kandidatët e vlerësuar pozitivisht nga komisionet vlerësuese, ORCA ka vlerësuar pozitivisht 4 prej tyre.

Fakulteti i Edukimit			
Titulli akademik i propozuar	**Numri i kandidatëve**	**Pozitiv nga ORCA**	**Negativ nga ORCA**
Profesor i rregullt	1	0	1
Profesor i asocuar	1	1	0
Profesor asistent	4	3	1
Total	6	4	2

Një kandidat ka publikuar vetëm në revista vendore dhe fqinje të fushës së albanologjisë që nuk kanë redaksi ndërkombëtare, dhe rrjedhimisht nuk njihen sipas UA1/2018.

Menaxhimi i burimeve financiare dhe njerëzore

ANALIZA E MBAJTJES SË LIGJËRATAVE NGA STAFI PA TITULL AKADEMIK TË PROFESORIT NË UNIVERSITETIN E PRISHTINËS

Publikues:
ORCA – Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim
www.orca-ks.org
info@orca-ks.org
Simon Shiroka, H-11, Nr. 8
Prishtina, 10000, Kosova

Autor:
Gramos Buçinca

Redaktor:
Rron Gjinovci

Hulumtues:
Gramos Buçinca, Robert Pajaziti

Prishtinë, tetor 2018

DEFINICIONE

Titull akademik – Titull që jepet në nivel universiteti për angazhim akademik. Në Universitetin e Prishtinës janë 4 tituj akademikë: asistent, profesor asistent, profesor i asocuar dhe profesor i rregullt.

Gradë shkencore – Niveli i përfundimit të studimeve nga një person. Në kuptimin e kësaj analize, gradat shkencore mund të jenë tri: baçelor i shkencës, master i shkencës, doktor i shkencës.

Të punësuar me kontratë të rregullt pune (tabela) – Persona të angazhuar me kontratë të rregullt pune në fakultetin e hulumtuar me titullin akademik të asistentit apo të ligjëruesit, sipas kuptimit të dhënë në definicionin 5, pika 2.

Bashkëpunëtorë (tabela) – Persona të angazhuar me kontratë si bashkëpunëtorë jashtë UP-së, apo nga fakultetet e tjera brenda UP-së.

Ligjërues – Ligjërues me kontratë të rregullt pune. Në tabelë paraqet personat me titullin akademik ligjërues, të fituar në kohën kur ky titull është dhënë në Universitetin e Prishtinës (sqarim: ky titull akademik nuk jepet më).

HYRJE

Ligjërimi nga persona jokompetentë paraqet problem të madh në cilësinë e mësimdhënies në institucionet e arsimit të lartë, të cilat e mbajnë përgjegjësinë kryesore të arsimimit superior në Kosovë.

Në mungesë të të dhënave të sakta rreth kësaj dukurie në Universitetin e Prishtinës (UP), Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim (ORCA) ka hartuar këtë analizë.

ORCA përmes kësaj analize tenton ta paraqesë numrin e lëndëve të mbajtura nga personeli pa titull akademik dhe pa gradë shkencore adekuate.

Me përfundimet që dalin prej kësaj analize, ORCA do ta mbështetë presionin e saj ndaj të gjitha niveleve vendimmarrëse për ndryshimin e gjendjes dhe ngritje të cilësisë në UP.

Të dhënat e përgjithshme

177 persona ligjërojnë 544 lëndë duke ushtruar kompetenca profesoriale pa kaluar nëpër procedurat e parapara statutare për titull profesorial. Sipas statutit, kryerjen e funksionit profesorial (profesor asistent, profesor i asocuar, profesor i rregullt) nuk mund ta bëjnë personat pa këtë titull, përveç në raste të veçanta.

328 lëndë ligjërohen nga 103 persona me titull akademik asistent. Sipas Statutit të UP-së, asistentët nuk duhet të mbajnë ligjërata, por vetëm pjesën e ushtrimeve dhe të ofrojnë asistim në realizimin sa më të mirë të planifikimeve për lëndë të caktuara.

Prej të gjithë numrit të personave pa titull profesorial që angazhohen për ligjërata, 76 kanë vetëm gradë shkencore të masterit dhe ligjërojnë në 212 lëndë.

Prej të gjithë personave të angazhuar si bashkëpunëtorë të jashtëm, 63 nuk kanë titull akademik të profesorit dhe ligjërojnë 166 lëndë. 11 nga këta bashkëpunëtorë kanë vetëm gradën master dhe ligjërojnë në 30 lëndë.

18 persona me gradën shkencore të masterit, në kundërshtim me Statutin, ligjërojnë në 34 lëndë në nivelin master. Ky është numri më shqetësues i përfshirjes inkompetente akademike të stafit, e cila është edhe e ndaluar me Statutin e Universitetit të Prishtinës.

Së bashku me 481[45] persona me titull akademik të profesorit, 177 ligjërues pa këtë titull paraqesin 26% të totalit të atyre që e kryejnë funksionin e ligjëruesit. Këta të fundit nuk i plotësojnë kriteret e Statutit dhe nuk kanë kaluar nëpër procedurat statutare për zgjedhje në pozitë që ushtron funksionin e ligjërimit.

Sipas Statutit të UP-së, detyra e ligjërimit në Universitet nuk është paraparë për asistentë dhe persona të tjerë të angazhuar për çfarëdo funksioni. Mbajtja e ligjëratave nga persona me përgatitje të tillë përveç që është në kundërshtim me Statutin, rrezikon seriozisht cilësinë e mësimdhënies në Universitet.

Po ashtu, këto të dhëna tregojnë për improvizim në menaxhimin e resurseve humane në UP, mungesë planifikimi adekuat për përtërirjen e kuadrit dhe për forma të keqpërdorimit të fondeve publike përmes favorizimit të personave të caktuar për pozita të caktuara akademike.

Praktikat ku një master i shkencës ligjëron në nivelin baçelor, e aq më keq edhe në master, dëmtojnë rëndë cilësinë e studimeve të çfarëdo niveli. Cilësia e studimeve rëndohet edhe më tepër kur shtojmë numrin e madh të bashkëpunëtorëve të jashtëm, të cilët pa iu nënshtruar shqyrtimit të kritereve të rrepta statutare për punësim, angazhohen në mësimdhënie, mbajnë provime e konsultime në ngarkesë të njëjtë sa një profesor.

Për shkak të kompensimit të ulët dhe joadekuat, këta bashkëpunëtorë, edhe në rastet kur janë me përgatitjen e nevojshme akademike, e kanë të vështirë t'ia kushtojnë rëndësinë e duhur punës së tyre në Universitet. UP-ja po ashtu angazhon bashkëpunëtorë me gradë shkencore të masterit për të ligjëruar.

Shqetësim tjetër është angazhimi i lektorëve në mbajtjen e ligjëratave në Fakultetin e Filologjisë. Ky veprim bie ndesh me nenin 179, paragrafi 2 të Statutit të UP-së, i cili thotë se lektorët në fakultetet e tjera pos në fakultetin amë i kanë të gjitha të drejtat dhe obligimet për mbajtjen e ligjëratave. Lektori i gjuhëve të huaja është personi i cili ligjëron gjuhë të huaj sipas nevojave të fakulteteve të tjera.

Krahas stafit jo të rregullt akademik, fakultetet e UP-së angazhojnë asistentë të rregullt në mësimdhënie në kundërshtim me Statutin e UP-së. Universiteti i Prishtinës vazhdon ta mbingarkojë stafin akademik me orë shtesë dhe me mbivendosje të pozitave (p.sh. asistenti i rregullt i një lënde është edhe i angazhuar si bashkëpunëtor i jashtëm për ligjërata në një lëndë tjetër, etj.), që minon seriozisht aftësinë e tyre në mësimdhënie dhe vlerësim efektiv.

	Numri i lëndëve të ligjëruara (numri i personave)								
	Të punësuar me kontratë të rregullt pune (114)					Bashkëpunëtor (63)			
Angazhimi	Ligjërues (11)		Asistent (103)						
Grada shkencore / Niveli i studimit	Doktor (5)	Master (6)	Doktor (41)	Master (59)	Nuk dihet grada shkencore (3)	Doktor (44)	Master (11)	Nuk dihet grada shkencore (8)	Totali për nivel të studimit
BA	11 (4)	3 (1)	101 (36)	62 (31)	8 (2)	59 (27)	15 (6)	7 (5)	266
MA	5 (2)	6 (3)	27 (14)	21 (12)	7 (3)	35 (20)	7 (3)	0 (0)	108
Nuk dihet niveli i studimit	7 (2)	18 (4)	28 (9)	72 (25)	2 (1)	23 (14)	8 (4)	12 (4)	170
Totali për gradë shkencore	23	27	156	155	17	117	30	19	544

Tabela 1. *– Të gjeturat e përgjithshme. Numri brenda kllapave paraqet numrin e personave të përfshirë në ligjërata. Numri jashtë kllapave paraqet numrin e lëndëve të ligjëruara.*

Fakulteti i Edukimit

18 persona pa titull akademik të profesorit ligjërojnë 81 lëndë.

Prej tyre, 12 kanë vetëm gradë shkencore të masterit dhe ligjërojnë në 44 lëndë.

Nga të gjithë të angazhuarit si bashkëpunëtorë të jashtëm, 4 nuk kanë titull akademik të profesorit dhe ligjërojnë 15 lëndë.

59 lëndë ligjërohen nga 14 persona me titull akademik asistent.

6 persona me gradën shkencore të masterit, në kundërshtim me Statutin, ligjërojnë në 14 lëndë në nivelin master.

	Numri i lëndëve të ligjëruara (numri i personave)						
	Të punësuar me kontratë të rregullt (15)				Bashkëpunëtor (4)		
Angazhimi	**Ligjërues (1)**	**Asistent (14)**					
Grada shkencore / **Niveli i studimit**	**Master (1)**	**Doktor (2)**	**Master (11)**	**Nuk dihet grada shken-core(1)**	**Doktor (1)**	**Nuk dihet grada shken-core (3)**	**Totali për nivel të studimit**
BA	3 (1)	2 (1)	6(4)	0(0)	0(0)	0(0)	11
MA	4 (1)	8(2)	10(5)	5(1)	3(1)	0(0)	30
Nuk dihet niveli i studimeve	0(0)	5(2)	21(8)	2(1)	0(0)	12(3)	40
Totali për gradë shkencore	7	15	37	7	3	12	81 (18)

Tabela 2 *– Fakulteti i Edukimit. Numri brenda kllapave paraqet numrin e personave të përfshirë në ligjërata. Numri jashtë kllapave paraqet numrin e lëndëve të ligjëruara.*

Fakulteti i Bujqësisë dhe i Veterinarisë

10 persona pa titull akademik të profesorit ligjërojnë 22 lëndë.

Prej tyre, 2 kanë vetëm gradë shkencore të masterit dhe ligjërojnë në 2 lëndë.

Nga të gjithë të angazhuarit si bashkëpunëtorë të jashtëm, 5 nuk kanë titull akademik të profesorit dhe ligjërojnë 8 lëndë. 2 prej tyre kanë vetëm gradën master dhe ligjërojnë në 2 lëndë.

14 lëndë ligjërohen nga 11 persona me titull akademik asistent.

2 persona me gradën shkencore të masterit, në kundërshtim me Statutin, ligjërojnë në 2 lëndë në nivelin master.

	Numri i lëndëve të ligjëruara (numri i personave)				
	Të punësuar me kontratë të rregullt (5)		Bashkëpunëtor (5)		
Angazhimi	Ligjërues (1)	Asistent (4)			
Grada shkencore / Niveli i studimit	Doktor (1)	Doktor (4)	Doktor (3)	Master (2)	Totali për nivel të studimit
BA	0(0)	4(2)	2(2)	0(0)	6
MA	2(1)	1(1)	3(2)	2(2)	8
Nuk dihet niveli i studimit	3(1)	4(2)	1(1)	0(0)	8
Totali për gradë shkencore	5	9	6	2	22 (10)

Tabela 3 *– Fakulteti i Bujqësisë dhe i Veterinarisë. Numri brenda kllapave paraqet numrin e personave të përfshirë në ligjërata. Numri jashtë kllapave paraqet numrin e lëndëve të ligjëruara.*

Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike

19 persona pa titull akademik të profesorit ligjërojnë në 43 lëndë.

Prej tyre, 4 kanë vetëm gradë shkencore të masterit dhe ligjërojnë në 4 lëndë.

Nga të gjithë të angazhuarit si bashkëpunëtorë të jashtëm, 14 nuk kanë titull akademik të profesorit dhe ligjërojnë në 30 lëndë.

4 lëndë ligjërohen nga 4 persona me titull akademik asistent.

	Numri i lëndëve të ligjëruara (numri i personave)				
	Të punësuar me kontratë të rregullt (5)		Bashkëpunëtor (14)		
Angazhimi	**Ligjërues (1)**	**Asistent (4)**			
Grada shkencore / **Niveli i studimit**	**Doktor (1)**	**Master (4)**	**Doktor (13)**	**Nuk dihet grada shkencore (1)**	**Totali për nivel të studimit**
BA	6(1)	4(4)	20(12)	1(1)	31
MA	3(1)	0(0)	9(5)	0(0)	12
Totali për gradë shkencore	9	4	29	1	43 (19)

***Tabela 4** – Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike. Numri brenda kllapave paraqet numrin e personave të përfshirë në ligjërata. Numri jashtë kllapave paraqet numrin e lëndëve të ligjëruara.*

Fakulteti Filozofik

16 persona pa titull akademik të profesorit ligjërojnë në 77 lëndë.

Prej tyre, 6 kanë vetëm gradë shkencore të masterit dhe ligjërojnë në 25 lëndë.

Nga të gjithë të angazhuarit si bashkëpunëtorë të jashtëm, 6 nuk kanë titull akademik të profesorit dhe ligjërojnë në 24 lëndë. Njëri prej tyre ka vetëm gradën master dhe ligjëron në 4 lëndë.

53 lëndë ligjërohen nga 11 persona me titull akademik asistent.

	Numri i lëndëve të ligjëruara (numri i personave)				
	Të punësuar me kontratë të rregullt (10)		Bashkëpunëtor (6)		
Angazhimi	**Asistent (10)**				
Grada shkencore / **Niveli i studimit**	**Doktor (5)**	**Master (5)**	**Doktor (5)**	**Master (1)**	**Totali për nivel të studimit**
BA	26(5)	21(5)	20(5)	4(1)	71
MA	6(3)	0(0)	0(0)	0(0)	6
Totali për gradë shken-core	32	21	20	4	77 (16)

Tabela 5 *– Fakulteti Filozofik. Numri brenda kllapave paraqet numrin e personave të përfshirë në ligjërata. Numri jashtë kllapave paraqet numrin e lëndëve të ligjëruara.*

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike

4 persona pa titull akademik të profesorit ligjërojnë në 8 lëndë.

Njëri prej tyre ka vetëm gradë shkencore të masterit dhe ligjëron në një lëndë.

Nga të gjithë të angazhuarit si bashkëpunëtorë të jashtëm, 2 nuk kanë titull akademik të profesorit dhe ligjërojnë në 4 lëndë.

Një lëndë ligjërohet nga një person me titull akademik asistent.

	Numri i lëndëve të ligjëruara (numri i personave)			
	Të punësuar me kontratë të rregullt (2)		Bashkëpunëtor (2)	
Angazhimi	**Ligjërues (1)**	**Asistent (1)**		
Grada shkencore / **Niveli i studimit**	**Doktor (1)**	**Master (1)**	**Doktor (2)**	**Totali për nivel të studimit**
BA	3(1)	1(1)	2(1)	6
MA	0(0)	0(0)	2(2)	2
Totali për gradë shkencore	3	1	4	8 (4)

***Tabela 6** – Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike. Numri brenda kllapave paraqet numrin e personave të përfshirë në ligjërata. Numri jashtë kllapave paraqet numrin e lëndëve të ligjëruara.*

Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe i Arkitekturës

14 persona pa titull akademik të profesorit ligjërojnë në 63 lëndë.

8 prej tyre kanë vetëm gradë shkencore të masterit dhe ligjërojnë në 28 lëndë.

Nga të gjithë të angazhuarit si bashkëpunëtorë të jashtëm, 3 nuk kanë titull akademik të profesorit dhe ligjërojnë 21 lëndë. Njëri prej tyre ka vetëm gradën master dhe ligjëron në 11 lëndë.

29 lëndë ligjërohen nga 8 persona me titull akademik asistent.

Një person me gradën shkencore të masterit, në kundërshtim me Statutin, ligjëron në 5 lëndë në nivelin master.

	Numri i lëndëve të ligjëruara (numri i personave)						
	Të punësuar me kontratë të rregullt (11)				Bashkëpunëtor (3)		
Angazhimi	Ligjërues (3)		Asistent (8)				
Grada shkencore / Niveli i studimeve	Doktor (1)	Master (2)	Doktor (3)	Master (5)	Doktor (2)	Master (1)	Totali për nivel të studimit
BA	1 (1)	0 (0)	13(3)	2(1)	2(1)	5(1)	23
MA	0(0)	0(0)	7(3)	0(0)	5(1)	5(1)	17
Nuk dihet niveli i studimeve	4(1)	8(2)	0(0)	7(5)	3(2)	1(1)	23
Totali për gradë shkencore	5	8	20	9	10	11	63 (14)

***Tabela 7** – Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe i Arkitekturës. Numri brenda kllapave paraqet numrin e personave të përfshirë në ligjërata. Numri jashtë kllapave paraqet numrin e lëndëve të ligjëruara.*

Fakulteti i Mjekësisë

24 persona pa titull akademik të profesorit ligjërojnë në 54 lëndë.

6 prej tyre nuk e kanë të treguar gradën shkencore dhe ligjërojnë në 16 lëndë.

Nga të gjithë të angazhuarit si bashkëpunëtorë të jashtëm, 4 nuk kanë titull akademik të profesorit dhe ligjërojnë 6 lëndë.

47 lëndë ligjërohen nga 18 persona me titull akademik asistent.

	Numri i lëndëve të ligjëruara (numri i personave)				
	Të punësuar me kontratë të rregullt pune (20)			Bash-këpunëtor (4)	
Angazhimi	**Ligjërues (1)**	**Asistent (19)**			
Grada shkencore / **Niveli i studimeve**	**Doktor (1)**	**Doktor (17)**	**Nuk dihet grada shkencore (2)**	**Nuk dihet grada shkencore (4)**	**Totali për nivel të studimit**
BA	1(1)	36(17)	8(2)	6(4)	51
MA	0(0)	1(1)	2(2)	0(0)	3
Totali për gradë shkencore	1	37	10	6	54 (24)

Tabela 8 *– Fakulteti i Mjekësisë. Numri brenda kllapave paraqet numrin e personave të përfshirë në ligjërata. Numri jashtë kllapave paraqet numrin e lëndëve të ligjëruara.*

Fakulteti Ekonomik

11 persona pa titull akademik të profesorit ligjërojnë në 26 lëndë.

Nga këta, 8 kanë vetëm gradë shkencore të masterit dhe ligjërojnë në 16 lëndë.

Nga të gjithë të angazhuarit si bashkëpunëtorë të jashtëm, 5 nuk kanë titull akademik të profesorit dhe ligjërojnë 10 lëndë. 3 prej tyre kanë vetëm gradën master dhe ligjërojnë në 5 lëndë.

16 lëndë ligjërohen nga 6 persona me titull akademik asistent.

	Numri i lëndëve të ligjëruara (numri i personave)				
	Të punësuar me kontratë të rregullt pune (6)		Bashkëpunëtor (5)		
Angazhimi	**Asistent (6)**				
Grada shkencore / **Niveli i studimeve**	**Doktor (1)**	**Master (5)**	**Doktor (2)**	**Master (3)**	**Totali për nivel të studimit**
BA	4(1)	11(5)	5(2)	5(3)	25
MA	1(1)	0(0)	0(0)	0(0)	1
Totali për gradë shkencore	5	11	5	5	26 (11)

Tabela 9 *– Fakulteti Ekonomik. Numri brenda kllapave paraqet numrin e personave të përfshirë në ligjërata. Numri jashtë kllapave paraqet numrin e lëndëve të ligjëruara.*

Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit

18 persona pa titull akademik të profesorit ligjërojnë 39 lëndë.

8 prej tyre kanë vetëm gradë shkencore të masterit dhe ligjërojnë në 15 lëndë.

Nga të gjithë të angazhuarit si bashkëpunëtorë të jashtëm, 10 nuk kanë titull akademik të profesorit dhe ligjërojnë 24 lëndë.

14 lëndë ligjërohen nga 7 persona me titull akademik asistent.

7 persona me gradën shkencore të masterit, në kundërshtim me Statutin, ligjërojnë në 11 lëndë në nivelin master.

	Numri i lëndëve të ligjëruara (numri i personave)			
	Të punësuar me kontratë të rregullt pune (8)		Bash-këpunëtor (10)	
Angazhimi	**Ligjërues (1)**	**Asistent (7)**		
Grada shkencore / **Niveli i studimeve**	**Master (1)**	**Master (7)**	**Doktor (10)**	**Totali për nivel të studimit**
BA	0(0)	4(3)	7(3)	11
MA	1(1)	10(6)	11(8)	22
Nuk dihet niveli i studimit	0(0)	0(0)	6(6)	6
Totali për gradë shkencore	1	14	24	39 (18)

***Tabela 10** – Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit. Numri brenda kllapave paraqet numrin e personave të përfshirë në ligjërata. Numri jashtë kllapave paraqet numrin e lëndëve të ligjëruara.*

Fakulteti Juridik

Fakulteti Juridik nuk ka bashkëpunëtorë të jashtëm pa titull akademik të profesorit.

8 persona pa titull akademik të profesorit ligjërojnë 15 lëndë, të gjithë me titullin akademik të asistentit.

Nga këta, 7 kanë vetëm gradë shkencore të masterit dhe ligjërojnë në 12 lëndë.

	Numri i lëndëve të ligjëruara (numri i personave)		
	Të punësuar me kontratë të rregullt pune (8)		
Angazhimi	**Asistent (8)**		
Grada shkencore / **Niveli i studimeve**	**Doktor (1)**	**Master (7)**	**Totali për nivel të studimit**
BA	2(1)	12(7)	14
MA	1(1)	0(0)	1
Totali për gradë shkencore	3	12	15 (8)

Tabela 11 *– Fakulteti Juridik. Numri brenda kllapave paraqet numrin e personave të përfshirë në ligjërata. Numri jashtë kllapave paraqet numrin e lëndëve të ligjëruara.*

Fakulteti i Shkencave Matematike - Natyrore

15 persona pa titull akademik të profesorit ligjërojnë në 64 lëndë.

8 prej tyre kanë vetëm gradë shkencore të masterit dhe ligjërojnë në 36 lëndë.

Nga të gjithë të angazhuarit si bashkëpunëtorë të jashtëm, 3 nuk kanë titull akademik të profesorit dhe ligjërojnë në 4 lëndë. 2 nga këta bashkëpunëtorë kanë vetëm gradën master dhe ligjërojnë në 6 lëndë.

49 lëndë ligjërohen nga 11 persona me titull akademik asistent.

2 persona me gradën shkencore të masterit, në kundërshtim me Statutin, ligjërojnë në 2 lëndë në nivelin master.

	Numri i lëndëve të ligjëruara (numri i personave)					
	Të punësuar me kontratë të rregullt pune (12)			Bashkëpunëtor (3)		
Angazhimi	Ligjërues (1)	Asistent (11)				
Grada shkencore / Niveli i studimeve	Master (1)	Doktor (6)	Master (5)	Doktor (1)	Master (2)	Totali për nivel të studimit
BA	0(0)	13(5)	1(1)	1(1)	1(1)	16
MA	1(1)	2(2)	1(1)	2(1)	0(0)	6
Nuk dihet niveli i studimit	9(1)	9(4)	23(3)	0(0)	1(1)	42
Totali për gradë shkencore	10	24	25	3	2	64 (15)

Tabela 12 *– Fakulteti i Shkencave Matematiko – Natyrore. Numri brenda kllapave paraqet numrin e personave të përfshirë në ligjërata. Numri jashtë kllapave paraqet numrin e lëndëve të ligjëruara.*

Fakulteti i Filologjisë

24 persona pa titull akademik të profesorit ligjërojnë 73 lëndë.

17 prej tyre kanë vetëm gradë shkencore të masterit dhe ligjërojnë në 49 lëndë.

Nga të gjithë të angazhuarit si bashkëpunëtorë të jashtëm, 7 nuk kanë titull akademik të profesorit dhe ligjërojnë 19 lëndë. 2 prej bashkëpunëtorëve kanë vetëm gradën master dhe ligjërojnë në 6 lëndë.

32 lëndë ligjërohen nga 11 persona me titull akademik asistent.

Fakulteti i Filologjisë angazhon 5 lektorë në kundërshtim me nenin 179, paragrafi 2 të Statutit të UP-së.

	Numri i lëndëve të ligjëruara (numri i personave)						
	Të punësuar me kontratë të rregullt pune (17)				Bashkëpunëtorë (7)		
Angazhimi	ligjërues (1)	Lektor (5)	Asistent (11)				
Grada shkencore / Niveli i studimit	Master (1)	Master (5)	Doktor (2)	Master (9)	Doktor (5)	Master (2)	Totali për nivel të studimit
BA	0(0)	0(0)	1(1)	0(0)	0(0)	0(0)	1
Nuk dihet niveli i studimit	1(1)	21(5)	10(1)	21(9)	13(5)	6(2)	72
Totali për gradë shkencore	1	21	11	21	13	6	73 (24)

***Tabela 13** – Fakulteti i Filologjisë. Numri brenda kllapave paraqet numrin e personave të përfshirë në ligjërata. Numri jashtë kllapave paraqet numrin e lëndëve të ligjëruara.*

METODOLOGJIA

Të dhënat e shfrytëzuara për analizë

Kjo analizë është bazuar mbi të gjeturat nga hulumtimi i Pasqyrave të angazhimeve të personelit akademik të secilit fakultet në Universitetin e Prishtinës, me përjashtim të Fakultetit të Arteve, për vitin akademik 2017–2018.

Objekt të hulumtimit janë mësimdhënësit e caktuar, sipas pasqyrave të përmendura më sipër, të cilët nuk e kanë ndonjërin nga titujt akademikë: profesor asistent, profesor i asocuar apo profesor i rregullt, të fituar në ndonjërin prej universiteteve vendore apo të huaja. Këtu bëjnë pjesë edhe bashkëpunëtorët e jashtëm që ligjërojnë lëndë e që nuk kanë titull akademik të profesorit.

Për arsye të ekuivalentimit të titujve shkencorë të masterit të artit me atë të doktorit të shkencës, sipas Statutit të UP-së, ORCA nuk e ka hulumtuar personelin e Fakultetit të Artit.

Lektorët e gjuhëve të huaja nuk bëjnë pjesë në këtë analizë, me përjashtim të Fakultetit të Filologjisë. Lektor, në kuptimin e Statutit, nënkupton personin i cili ndihmon në organizim dhe mësimdhënie të lëndëve të gjuhëve dhe parashihet që ky person fakultetin amë (me të cilin ka kontratë të rregullt pune) të mos e ketë të njëjtë me atë në të cilin e kryen aktivitetin e përmendur.

Inxhinierët e Diplomuar të Arkitekturës (IDA), për nevoja të këtij hulumtimi, në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe të Arkitekturës, janë ekuivalentuar me gradën shkencore të masterit.

Legjislatura në bazë të së cilës është hartuar kjo analizë bazohet në:

1. Statutin e UP-së46, neni 171, paragrafi 1:

"*1. Në stafin akademik të Universitetit do të jenë personat e angazhuar në:*

1.1. mësimdhënie akademike;
1.2. kërkime shkencore;
1.3. krijimtari artistike."

– Përmes paragrafit 1 mund të konkludohet se vetëm personeli akademik angazhohet në ligjërim, i cili paraqet aktivitetin kryesor të mësimdhënies.

dhe paragrafi 2:

"*2. Personeli akademik përbëhet nga:*

2.1. Profesorët e rregullt;
2.2. Profesorët e asocuar;
2.3. Profesorët asistentë;
2.4. Asistentë universiteti;
2.5. Lektorët dhe Korepetitorët (Fakulteti i Arteve)."

– Përmes paragrafit 2 mund të konkludohet që fakultetet në UP nuk mund të angazhojnë për mësimdhënie persona të tjerë të cilët nuk përfshihen në këtë paragraf.

46 Statuti i Universitetit të Prishtinës; linku: https://www.uni-pr.edu/inc/doc/statuti1.pdf

2. Statuti i UP-së, neni 178, paragrafi 3:

"Asistentët mbajnë orët e ushtrimeve në studimet bachelor dhe master. Përjashtimisht asistenti që është rizgjedhur, në mungesë të profesorit për lëndën, mund të autorizohet për mbajtjen e ligjëratave të kufizuara në studimet bachelor me autorizimin e këshillit të njësisë akademike dhe nën mbikëqyrjen e një mësimdhënësi nga departamenti – katedra."

dhe paragrafi 1.3:

"Të jetë i regjistruar në studimet e doktoratës në Universitet me rastin e rizgjedhjes."

3. Statuti i UP-së, neni 99, paragrafi 3:

"Planprogrami, parakushtet për vijim dhe çështjet e tjera organizative aprovohen nga këshillat e njësive akademike sipas propozimeve të profesorit i cili është përgjegjës për lëndën. Vendimi përfundimtar merret nga Senati."

–..... Përmes këtij paragrafi të nenit 99, mund të konkludohet që vetëm profesori është përgjegjës për lëndën.

ANALIZA E MENAXHIMIT TË FINANCAVE PËR PAGAT E STAFIT AKADEMIK NË UNIVERSITETIN E PRISHTINËS

Publikues:
ORCA – Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim
www.orca-ks.org
info@orca-ks.org
Simon Shiroka, H-11, Nr. 8
Prishtina, 10000, Kosova

Autor:
Rron Gjinovci

Hulumtues:
Venera Çoçaj

Ndihmës-hulumtues:
Robert Pajaziti

Prishtinë, tetor 2018

DEFINIME

Norma – Fondi i orëve i caktuar në rregullore për të ardhurat personale të stafit akademik. Ky fond i orëve është i përcaktuar për javë dhe nënkupton numrin e orëve që pjesëtarët e stafit akademik i kalojnë me studentët përgjatë punës së tyre. Për këtë fond orësh, stafi akademik paguhet sipas kontratës së rregullt.

Mbinorma – Orët e mbajtura jashtë përcaktimit të normës. Për çdo orë mbi normën e përcaktuar paguhen shuma të caktuara në rregulloren për të ardhura personale.

Staf akademik me kontratë të rregullt pune - Stafi i punësuar për kohë më të gjatë se 1 vjet me kontratë të rregullt pune.

Bashkëpunëtor i jashtëm – Person i angazhuar me kontratë për punë të caktuar jo më të gjatë se 1 vjet.

HYRJE

Pas një sërë publikimesh që lidhen me integritetin akademik, menaxhimin e resurseve njerëzore, ORCA vjen me një analizë për përdorimin e mjeteve financiare kur është fjala për stafin akademik të Universitetit të Prishtinës.

Jemi mësuar të dëgjojmë nga ana e menaxhmenteve të UP-së për mungesën e fondeve si shkaktar i mungesës së stafit akademik dhe raportit shqetësues të profesorëve për kokë studenti. 1:46 është raporti profesor për studentë, ndërkohë që në rajon gjysma e numrit të studentëve nga Universiteti i Prishtinës ndan një profesor.

ORCA ka nxjerrë së fundi të dhëna po ashtu shqetësuese lidhur me mbajtjen e ligjëratave nga persona pa tituj profesorialë, sipas së cilave, më shumë se 500 lëndë ligjërohen nga persona të tillë.

Këto dhe shumë indikacione të tjera na kanë shtyrë drejt hulumtimit që do të prezantohet para jush e i cili shqyrton mundësitë reale financiare të Universitetit të Prishtinës për t'i përmbysur të dhënat e mësipërme.

Sa para harxhon Universiteti në honorare, të cilat në UP quhen "mbinorma"? Sa para harxhon në bashkëpunëtorë të jashtëm, të cilët për paga shumë më të vogla kryejnë punë të njëjta sikurse profesorët me paga fikse? Po t'i menaxhonte ndryshe të gjitha paratë e shpenzuara për mbinorma dhe bashkëpunëtorë të jashtëm, çfarë efekte do të prodhoheshin?

Kjo analizë e bazuar në një hulumtim origjinal mundohet t'i ngritë këto pyetje dhe t'i orientojë përgjigjet për to me qëllim ngritjen e një diskutimi publik për menaxhimin e mirë dhe efikas të milionave të fondeve publike në Universitetin e Prishtinës.

METODOLOGJIA

Baza ligjore e normave dhe mbinormave - Rregullorja e financave

Angazhimi i stafit akademik përtej detyrimeve të parapara në kontrata të rregullta rregullohet përmes Rregullores për të ardhurat personale të personelit akademik, shtesat për funksione, honoraret dhe komisionet e përhershme në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” me nr. 2/486 e datës 11.09.2017.

Llogaritja e orëve (normave dhe mbinormave) sipas pasqyrave të angazhimit

ORCA ka parë pasqyrat e angazhimit të stafit akademik dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm për secilin fakultet të vitit 2017/2018. Në këto pasqyra përcaktohet planifikimi i mbajtjes së orëve për javë, në semestrin dimëror dhe veror. Në këto pasqyra janë të parapara normat dhe mbinormat e secilit pjesëtar të stafit akademik. Në këtë mënyrë janë nxjerrë angazhimet javore të rregullta (normat) dhe të parregullta (mbinormat) të të gjithë pjesëtarëve të stafit akademik veç e veç.

Shumat e nxjerra për javë sa u përket mbinormave dhe angazhimit të bashkëpunëtorëve të jashtëm janë shumëzuar me numrin e javëve për një semestër dhe kështu janë nxjerrë shpenzimet semestrale të secilit fakultet. Këto janë mbledhur dhe kanë dhënë numrin e përgjithshëm të mbinormave nga stafi aktual si dhe angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm.

Përcaktimi i vlerave sipas rregullores për financa

Numri i orëve të mbledhura, në përputhje me pozitat akademike dhe procedurat e parapara në rregullore për financa në bazë të së cilës paguhen pjesëtarët e stafit akademik, janë përkthyer në vlera (në euro) të mbinormave dhe angazhimit të bashkëpunëtorëve të jashtëm.

Limiti metodologjik

Të dhënat janë përpunuar në mënyrë gjenuine nga ORCA. Për shkak të pamundësisë për të marrë informata të detajuara dhe të sakta të numrit të orëve të realizuara (të normave dhe mbinormave), përllogaritjet në këtë raport mund të mos jenë të një preciziteti të lartë me një mundësi devijimi prej 4% në të dy kahjet e vlerave të dhëna.

MBINORMAT DHE ANGAZHIMET E BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM NË UP

Pas akreditimit të programeve nga Agjencia e Kosovës për Akreditim, mbetet në diskrecion të institucioneve të arsimit të lartë zbatimi i programit të akreditуar. Në pamundësi të monitorimit të vazhdueshëm të zbatimit të programeve të akredituara dhe aspekteve të tjera të akreditimit, institucionet e arsimit të lartë janë pothuajse të pakontrolluara në zbatimin e programeve.

Kriteret që kërkohen për akreditim programesh, lidhur me kualifikimet e stafit akademik, përcaktojnë vetëm nevojën që 3 doktorë shkence me kontrata të rregullta pune të jenë përgjegjës formalisht për programin, ndërkaq zbatimin e programit dhe organizimin e lëndëve të parapara në program institucionet e arsimit të lartë e bëjnë në diskrecion të plotë.

Si rrjedhojë, Universiteti i Prishtinës një numër të madh të lëndëve e mban përmes bashkëpunëtorëve të jashtëm dhe duke e angazhuar stafin e brendshëm jashtë orarit (normës) të përcaktuar në kontrata dhe rregullore. Për t'i realizuar programet e akredituara, UP-ja ka angazhuar 177 persona që ligjërojnë 544 lëndë duke ushtruar kompetenca profesoriale pa qenë profesorë.[47]

Analiza e ORCA-s lidhur me mbajtjet e ligjëratave nga personat jokompetentë, sipas Statutit të UP-së, që i parapriu kësaj analize të shpenzimeve, ka nxjerrë të dhëna shqetësuese për këtë dukuri:

> *"328 lëndë ligjërohen nga 103 persona me titull akademik asistent. Sipas Statutit të UP-së, asistentët nuk duhet të mbajnë ligjërata, por vetëm pjesën e ushtrimeve dhe të ofrojnë asistim në realizimin sa më të mirë të planifikimeve për lëndë të caktuara. Prej të gjithë numrit të personave pa titull profesorial që angazhohen për ligjërata, 76 kanë vetëm gradë shkencore të masterit dhe ligjërojnë në 212 lëndë."*[48]

Për pagesa të mbinormave (pra të stafit ekzistent me kontrata të rregullta pune) të planifikuara në 2017-2018 për semestrin dimëror, UP-ja ka harxhuar 1,217,644 euro. Ndërkohë që për bashkëpunëtorë të jashtëm ka harxhuar 557.027 euro.

Për pagesa të mbinormave (të stafit ekzistent me kontrata të rregullta pune) të planifikuara në 2017-2018 për semestrin veror, UP-ja ka harxhuar 1,114,416 euro. Ndërsa për bashkëpunëtorë të jashtëm 479,240 euro.

Marrë ndaras, gjatë vitit akademik 2017-2018 UP-ja ka shpenzuar 2,333,060 euro për mbinorma të stafit ekzistues akademik. Ndërsa për të njëjtin vit akademik, për bashkëpunëtorë të jashtëm ka shpenzuar 1,036,265. Në total del se UP-ja gjatë vitit akademik ka shpenzuar 3,368,325 euro për mbinorma dhe bashkëpunëtorë të jashtëm.

Shpenzimet më të mëdha të mbinormave brenda vitit akademik 2017–2018 i ka bërë Fakulteti i Mjekësisë – rreth 623 mijë euro, i pasuar nga Departamenti i Arteve Muzikore në kuadër të Fakultetit të Arteve – rreth 293 mijë euro, ndërkohë që i gjithë Fakulteti i Arteve kap shumën prej rreth 456 mijë eurosh.

Po ashtu, me shpenzimet për bashkëpunëtorë të jashtëm, gjatë vitit akademik 2017–2018, prin Fakulteti i Mjekësisë me rreth 244 mijë euro i pasuar nga Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë me rreth 101 mijë euro.

Shpenzimet më të vogla të mbinormave brenda vitit akademik 2017–2018 i ka bërë Fakulteti i Sporteve me rreth 49 mijë euro. Ndërkaq me shpenzimet më të vogla për bashkëpunëtorë të jashtëm është Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës me rreth 15 mijë euro.

Të dhëna më të detajuara për secilin fakultet mund të gjenden në dy tabelat e mëposhtme.

47 http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2018/10/Analiza-e-mbajtjes-se-ligjeratave-nga-stafi-pa-titull-akademik-te-profesorit-ne-UP.pdf

48 Po aty.

Figura 1. *Tabela e mbinormave për vitin akademik 2017–2018 për stafin me kontrata të rregullta pune. Sqarim: Fakulteti i Arteve është dhënë i ndarë në 3 departamente, sipas ndarjes ekzistuese në pasqyrat financiare për të ardhurat e personelit akademik. Shumat nga këto 3 departamente janë trajtuar së bashku përgjatë tekstit të kësaj analize.*

	MBINORMA		
	Semestri dimëror	**Semestri veror**	**Viti Akademik 2017/2018**
Fakulteti i Edukimit	€ 78,510.00	€ 65,010.00	€ 143,520.00
Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë	€ 81,105.00	€ 58,410.00	€ 139,515.00
Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike	€ 36,465.00	€ 27,705.00	€ 64,170.00
Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	€ 29,824.00	€ 35,385.00	€ 65,209.00
Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës	€ 72,150.00	€ 49,140.00	€ 121,290.00
Fakulteti Juridik	€ 28,125.00	€ 35,625.00	€ 63,750.00
Fakulteti i Mjekësisë	€ 319,590.00	€ 303,705.00	€ 623,295.00
Fakulteti Ekonomik	€ 68,775.00	€ 64,965.00	€ 133,740.00
Fakulteti Filozofik	€ 64,980.00	€ 49,950.00	€ 114,930.00
Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore	€ 88,890.00	€ 71,475.00	€ 160,365.00
Fakulteti i Shkencave Sportive	€ 18,240.00	€ 31,665.00	€ 49,905.00
Fakulteti i Arteve – Departamenti i Arteve Muzikore	€ 150,225.00	€143,475.00	€ 293,700.00
Fakulteti i Arteve - Depatramenti i Arteve Dramatike	€ 66,060.00	€ 60,630.00	€ 126,690.00
Fakulteti i Arteve – Departamenti i Arteve Figurative	€ 18,390.00	€ 18,060.00	€ 36,450.00
Fakulteti Filologjik	€ 96,315.00	€ 99,216.00	€ 195,531.00
TOTAL	€ 1,217,644.00	€ 1,114,416.00	€ 2,332,060.00

Figura 2. *Tabela e angazhimeve të bashkëpunëtorëve të jashtëm për vitin akademik 2017–2018. Sqarim: Fakulteti i Arteve është dhënë i ndarë në 3 departamente, sipas ndarjes ekzistuese në pasqyrat financiare për të ardhurat e personelit akademik. Shumat nga këto 3 departamente janë trajtuar së bashku përgjatë tekstit të kësaj analize.*

	Bashkëpunëtorët e jashtëm		
	Semestri dimëror	**Semestri veror**	**Viti Akademik 2017/2018**
Fakulteti i Edukimit	€ 30,000.00	€ 23,520.00	€ 53,520.00
Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë	€ 54,300.00	€ 47,250.00	€ 101,550.00
Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike	€ 44,475.00	€ 32,700.00	€ 77,175.00
Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	€ 27,000.00	€ 21,900.00	€48,900.00
Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës	€ 9,900.00	€ 5,120.00	€15,020.00
Fakulteti Juridik	€ 16,200.00	€ 17,700.00	€ 33,900.00
Fakulteti i Mjekësisë	€ 112,950.00	€ 131,850.00	€ 244,800.00
Fakulteti Ekonomik	€ 31,500.00	€ 34,800.00	€ 66,300.00
Fakulteti Filozofik	€ 29,400.00	€ 22,950.00	€ 52,350.00
Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore	€ 27,150.00	€ 15,150.00	€ 42,300.00
Fakulteti i Shkencave Sportive	€ 18,000.00	€ 13,050.00	€ 31,050.00
Fakulteti i Arteve - Departamenti i Arteve Muzikore	€ 45,900.00	€ 4,800.00	€ 50,700.00
Fakulteti i Arteve - Depatramenti i Arteve Dramatike	€ 48,450.00	€ 40,950.00	€ 89,400.00
Fakulteti i Arteve – Departamenti i Arteve Figurative	€ 32,400.00	€ 35,400.00	€ 67,800.00
Fakulteti Filologjik	€ 29,400.00	€ 32,100.00	€ 61,500.00
TOTAL	€ 557,025.00	€ 479,240.00	€ 1,036,265.00

MUNDËSI TJERA TË HARXHIMIT TË PARAVE

Më poshtë është dhënë tabela nga rregullorja për të ardhurat e stafit akademik ku mund të shihen pagat e përcaktuara mujore për stafin akademik në Universitetin e Prishtinës. Tabela e ndarë në 3 kolona përbëhet nga "Titulli" që tregon titujt ekzistues akademikë, kolona "Orë në javë" tregon normën e kontraktuar për titujt përkatës si dhe kolona "Paga mujore" sasinë e pagesës sipas kontratave të rregullta. Bashkëpunëtorët e jashtëm të cilët nuk janë të kategorizuar në këtë tabelë nuk marrin paga fikse, ata paguhen për shërbim, pra për orë të caktuara të mbajtura në kuadër të UP-së.

Figura 3. *Tabela e të ardhurave nga Rregullorja e të ardhurave*

Titulli	Orë në Javë	Paga mujore
Profesorët e rregullt	6	1429,54
Profesorët e asocuar	6	1283,34
Profesorët asistent	6	1137,14
Ligjëruesit	10	990,94
Lektorët	10	844,73
Korepetitorët	10	844,73
Asistentët	10	772,50
Asistent i ri	10	698,75

Nëse bazohemi në tabelën e mësipërme shohim se kostoja mujore e një profesori asistent që ka kompetencën e plotë profesoriale (të ligjëruarit e lëndës dhe të tjera kompetenca profesoriale) është 1137,14 euro. Me llogaritje të thjeshtë konkludohet se kostoja vjetore e një profesori asistent është 13,609,68 euro. Me 1 milion euro, UP-ja do të mund të punësonte rreth 73 profesorë asistentë.

Ndërkaq me 3.3 milionë euro, UP-ja do të mund të punësonte 247 profesorë asistentë, gjë që do të shënonte rritje prej 50% të stafit ekzistues akademik, i cili përbëhet prej diçka më shumë se 550 veta me tituj profesorialë (profesor asistent, profesor i asocuar, profesor i rregullt).

Një ndarje tjetër e fondit të keqmenaxhuar prej 3.3 milionë eurosh do të mund të ishte e tillë që me 1 milion të hapeshin dhjetëra vende të reja pune për staf akademik (profesorë asistentë dhe asistentë të rinj – shih tabelën e të ardhurave personale). Ndërsa pjesa tjetër prej rreth 2.3 milionë eurosh të ndahej për ta krijuar fondin për shkencë të Universitetit të Prishtinës, ku profesorët do të paguheshin për çdo artikull të botuar si autor i parë në revistat e indeksuara në Web of Science apo në Scopus sipas modelit çek apo italian. Kjo do të ndikonte në rritjen e numrit të stafit akademik dhe numrit të publikimeve shkencore nga Universiteti i Prishtinës. Me automatizëm, një lëvizje e tillë do ta radhiste shumë më lart sesa është sot Universitetin e Prishtinës dhe do ta përmirësonte ndjeshëm nivelin e mësimdhënies në UP.

PËRFUNDIME

Një fond prej 2.3 milionë eurosh keqmenaxhohet dhe keqpërdoret për ta paguar stafin akademik ekzistues për orë që do të mund të mbaheshin nga të punësuar të rregullt.

Universiteti i Prishtinës harxhon rreth 1 milion euro për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm, të cilëve u jep kompetenca profesoriale pa kaluar nëpër filtrat e paraparë statutar.

UP-ja nuk ka kapacitete për të ofruar personel akademik për të gjitha programet e akreditуara.

Një numër i konsiderueshëm i personave jokompetentë mban ligjërata në qindra lëndë.

Raporti profesor/studentë në Universitetin e Prishtinës është raporti më i keq në rajon, si pasojë e keqmenaxhimit dhe keqpërdorimit të fondeve publike.

Universiteti i Prishtinës nuk ka fond për shkencë, si pasojë e keqmenaxhimit dhe keqpërdorimit të fondeve publike.

REKOMANDIME

Fondin prej 3.3 milionë eurosh Universiteti i Prishtinës duhet ta ndajë për rritjen e stafit të rregullt akademik.

UP-ja duhet ta themelojë fondin për shkencë.

UP-ja duhet ta ulë numrin e programeve të akreditуara, ta rritë cilësinë e mësimdhënies në programet ekzistente dhe ta ulë periodikisht numrin e studentëve që pranon në kuadër të programeve ekzistente.

UP-ja duhet ta ndalojë praktikën jashtëstatutare të kryerjes së funksioneve profesoriale nga personat që nuk janë emëruar apo zgjedhur në pozita profesoriale, sipas dispozitave të Statutit të miratuar në Kuvendin e Republikës.

ORCA është anëtare e Koalicionit për Integritet dhe Transparencë në Universitet - KITU, mbështetur nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur - KFOS. Ky raport është pjesë e programit të KITU-së. Ky grant është realizuar me përkrahjen e projektit Sfidimi i Korrupcionit në Arsimin e Lartë i financuar nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS).

KITU
KOALICIONI PËR INTEGRITET DHE TRANSPARENCË NË UNIVERSITET

KFOS
Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
Kosovo Foundation for Open Society
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo

Ky botim është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK
DANIDA | INTERNATIONAL DEVELOPMENT COOPERATION